

# RAPORT

## I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”

Kolegji Universitar “LOGOS”

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

Dr. Alketa Grepcka



Dr. Ervin Ramollari



Maj, 2019

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Koleji Universitar “LOGOS”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara/ Departamenti Informatikë e Zbatuar
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr.1055, datë 29.07.2009 <i>(leja për ushtrimin e veprimtarisë akademike: UMASH Nr. 396, datë 02.08.2010)</i>
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH Nr. 282, datë 04.07.2012/ VKA Nr. 338, datë 08.06.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në “Informatikë e zbatuar”
6	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	180
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
16	Numri i studentëve	44 studentë



## Tabela e Përmbajtjes

<b>HYRJE .....</b>	<b>5</b>
<b>ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË .....</b>	<b>11</b>
<b>1.Misioni/Objektivat e programit të studimit .....</b>	<b>14</b>
Pjesa përshkimore.....	14
Vlerësimi sipas Standardeve .....	14
<b>2.Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit) .....</b>	<b>17</b>
Pjesa përshkimore.....	17
Vlerësimi i Treguesve të matshëm .....	17
<b>3.Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit .....</b>	<b>19</b>
Pjesa përshkimore.....	19
Vlerësimi i Treguesve të matshëm .....	19
Vlerësimi sipas Standardeve .....	16
<b>4.Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit .....</b>	<b>25</b>
Pjesa përshkimore.....	25
Vlerësimi i Treguesve të matshëm .....	26
Vlerësimi sipas Standardeve .....	26
<b>5.Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare .....</b>	<b>29</b>
Pjesa përshkimore.....	29
Vlerësimi i Treguesve të matshëm .....	29
Vlerësimi sipas Standardeve .....	30
<b>6.Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë.....</b>	<b>31</b>
Pjesa përshkimore.....	31
Vlerësimi i Treguesve të matshëm .....	32
Vlerësimi sipas Standardeve .....	34
<b>7. Programi i studimit, organizimi i tij .....</b>	<b>37</b>
Pjesa përshkimore.....	37
Vlerësimi i Treguesve të matshëm .....	38
Vlerësimi sipas Standardeve .....	40
<b>8.Mësimdhënia .....</b>	<b>42</b>
Pjesa përshkimore.....	42
Vlerësimi i Treguesve të matshëm .....	43
<b>9. Studentët .....</b>	<b>45</b>

Pjesa përshkrimore.....	45
Vlerësimi i Tregues të matshëm .....	45
Vlerësimi sipas Standardeve .....	46
<b>10. Kërkimi shkencor .....</b>	<b>50</b>
Pjesa përshkrimore.....	50
Vlerësimi i Treguesve të matshëm .....	51
<b>11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun .....</b>	<b>52</b>
Pjesa përshkrimore.....	52
Vlerësimi i Treguesve të matshëm .....	52
Vlerësimi sipas Standardeve .....	52
<b>I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË .....</b>	<b>55</b>
<b>II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).....</b>	<b>55</b>
<b>ANEKSE .....</b>	<b>57</b>

## HYRJE

### **Të dhëna për programin e studimit Bachelor në “Informatikë e zbatuar”**

Kolegji Universitar “LOGOS” është licencuar me VKM Nr. 1055, datë 29.07.2009 ku është miratuar organizimi i tij në dy fakultete përkatësisht:

1. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, me programin e studimit të ciklit të parë **“Informatikë e zbatuar”**.
2. Fakulteti Ekonomik

Ministria e Arsimit dhe Shkencës me Urdhër Nr. 396, datë 02.08.2010, ka miratuar lejen për ushtrimin e veprimtarisë akademike, ndër të tjera dhe për programin e studimit:

#### **a) Informatikë e zbatuar;**

Me Urdhër Nr. 408, datë 13.07.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është miratuar hapja e njësisë së re në KU “LOGOS”:

3. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor

Ministria e Arsimit dhe Shkencës me Urdhër të Ministrit Nr. 282, datë 04.07.2012 ka miratuar:

1. Akreditimin institucional të KU “LOGOS”, bazuar në Vendimin Nr. 338, datë 08.06.2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë;
2. Akreditimin e disa programeve të studimit të ciklit të parë në përfundim të të cilave lëshohet diplomë “Bachelor”, ndër të tjera dhe për programin e studimit:

#### **a. Informatikë e zbatuar;**

Gjithashtu KU “LOGOS” ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me agjencinë Britanike të sigurimit të cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 95, datë 20.10.2017.

Aktualisht programi ka hyrë në procesin e riakreditimit. Programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” ofrohet nga Departamenti Informatikë e Zbatuar, me një kohëzgjatje normale 3-vjeçare dhe numër kreditesh 180 ECTS.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm Periodik (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”, ofruar nga KU “LOGOS”. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.

### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ:

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Dr. Alketa Grepcka dhe Dr. Ervin Ramollari si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Emisa Isufaj dhe gjatë vizitës në Institucion nga Znj. Majlinda Demirneli.

Kolegji Universitar "LOGOS" është njogur me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 30.04.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 59/6 Prot., datë 30.04.2019. KU "LOGOS" përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 58/7 Prot., datë 08.05.2019 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e Vlerësimit u njohën me komentet dhe vendosën të japin argumentat e mëposhtme dhe të bëjnë disa reflektime si më poshtë:

GVJ në punën e tij është munduar të reflektojë qartë të gjithë konstatimet e evidentuara në dokumentacionin e paraqitur nga Kolegji Universitar "Logos", mendimet e përthithura gjatë takimeve të zhvilluara sipas një agjende të mirëpërcaktuar dhe të aprovuar nga vetë Institucioni. Dëshirojmë t'ju bëjmë me dije se rekomandimet e paraqitura kanë synimin në përmirësimin e atyre problematikave që kemi konstatuar gjithmonë në drejtim të rritjes së cilësisë së programit të studimit.

Në lidhje me komentet e paraqitura po japim mendimin tonë si vijon më poshtë:

#### **Konstatimi në draft-raport (fq.8,15):**

Kolegji Universitar "Logos" nuk ka paraqitur në dokumentacionin e tij të dorëzuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë asnjë shkresë në lidhje me kërkesën e paraqitur pranë Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë për miratimin e reduktimit të stafit akademik. Bëjmë me dije se gjatë takimeve të zhvilluar me Drejtuesin e Departamentit dhe Drejtuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore na është komunikuar në mënyrë verbale për këtë kërkesë por asnjë dokumentacion i cili mund të merret gjatë vizitës nuk është paraqitur nga ana e Institucionit.

Konsiderojmë që kërkesa e paraqitur në datë 10.01.2019 me nr. 48 Prot. nga Rektori i Kolegjit Universitar "Logos" dhe shtojca 4: Argumentimi analitik si edhe Urdhëri Nr. 29 datë 21.01.2019 me nr. 223/1 prot nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për Ngritjen e Grupit të Punës për Vlerësimin e Numrit të Stafit Akademik me Kohë të plotë për Secilën Njësi Bazë në Kolegjin Universitar "Logos" përbëjnë një dokumentacion për të cilën GVJ njihet për herë të parë.

Në draft-raportin e vlerësimit të jashtëm, faqe 17 citojmë:

*Për sa i përket kriterit që personeli akademik me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar në program, GVJ ka llogaritur orët e realizuara në auditor nga PAE dhe orët e realizuara nga PAK. Në përllogaritjen e orëve, është marrë për bazë versioni i Tabelës 13 me modulet dhe pedagogët përkatës (jo me lëndët dhe titullarët përkatës), pasi ky version reflekton ngarkesën reale mësimore. Si rezultat, për vitin akademik 2017-2018, numri i orëve të realizuara nga PAE është 1380, nga PAK është 735, dhe përqindja e orëve të realizuara nga PAE rezulton të jetë 65.2%. Për vitin akademik 2018-2019, numri (i planifikuar) i orëve të realizuara nga PAE është 1080, nga PAK është 810, dhe përqindja e orëve të realizuara nga PAE rezulton të jetë 57.1%. Pra kriteri nuk përmbushet, edhe pse shifrat nuk janë shumë larg pragut 70%. Rekomandohet që departamenti ta rishikojë planin mësimor për vitet akademike në vazhdim, duke angazhuar më shumë personel akademik me kohë të plotë.*

Gjithashtu në fq.7 dhe 15 të RVJ-së citojmë:

*Për vitin akademik 2012-2013 nuk ka patur të angazhuar PAE – 0%, janë angazhuar 17 PAK – 100% (3 Dr, 14 MSc);*

*Për vitin akademik 2013-2014 nuk ka patur të angazhuar PAE – 0%, janë angazhuar 16 PAK – 100% (3 Dr, 13 MSc);*

*Për vitin akademik 2014-2015 janë angazhuar 9 PAE – 75% (2 Dr, 6 MSc, 1 Ba), dhe 3 PAK – 25% (2 Prof. As., 1 MSc);*

*Për vitin akademik 2015-2016 janë angazhuar 8 PAE – 62% (1 Prof. Dr., 1 Dr., 5 MSc, 1 Ba) dhe 5 PAK – 38% (3 Prof. As., 2 MSc);*

*Për vitin akademik 2016-2017 janë angazhuar 8 PAE – 57% (2 Prof. Dr., 6 MSc) dhe 6 PAK – 43% (1 Prof. As., 1 PhD, 2 Dr., 2 MSc);*

*Për vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar 7 PAE – 64% (2 Prof. Dr., 5 MSc.) dhe 4 PAK – 36% (1 Prof. As., 2 Dr. dhe 1 MSc.);*

*Për vitin akademik 2018-2019 angazhohen 4 PAE – 44% (1 Prof. Dr., 3 MSc.) dhe 5 PAK – 56% (1 Prof. As., 1 PhD, 1 Dr., 2 MSc.)*

*Raporti PAE/PAK në periudhën akademike 2012-2014 është zero, pasi nuk janë angazhuar staf akademik PAE. Përmirësime vihen re për periudhën akademike 2014-2017 ku numri i stafit PAE mbizotëron. Për vitin akademik 2017-2018 kemi rënie e cila rëndohet për vitin 2018-2019 në një reduktim në vetëm 4 personel akademik me kohë të plotë.*

Duke konsideruar faktet e mësipërme GVJ është i mendimit që Institucioni nuk paraqet në vite një përmirësim në lidhje me numrin e stafit akademik me kohë të plotë. Në kërkesën e paraqitur Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Kolegji Universitar “Logos” kërkon një reduktim të stafit akademik të departamentit në 5 anëtarë ku të paktën dy prej tyre të jenë me grada shkencore. Për vitin akademik 2018-2019 në Departamentin Informatikë e Zbatuar aktualisht angazhohet 1 prof. Dr dhe 3 MSc. Pra në thelb Insitucioni nuk përmbush kërkesën që ka paraqitur në Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë.

Për sa theksuar më sipër dhe në raport, GVJ nuk ndryshon gjykimin e tij dhe shpreh që rekomandimet e paraqitura janë të drejta dhe plotësimi i tyre do të sjellë një përmirësim të cilësisë në mësimdhënie për këtë program studimi.

#### **Konstatimi në draft-raport (fq.11).**

GVJ në hartimin e rekomandimit është bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në takimet e zhvilluara në Institucion. GVJ është plotësisht dakord të bëjë korrigjimin në lidhje me Qëndren e Kërkimit dhe Zhvillimit Shkencor e cila është njësi e tretë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe jo e Departamentit Informatikë e Zbatuar. Nga ana tjetër GVJ nuk bën ndryshim në rekomandimin e tij për argumentimet si më poshtë vijon:

Duke shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga Institucioni dhe dokumentacionin shtesë [Dok. 32 – Përberja e Qëndres së Kërkimit Shkencor 2014-2015, 2015-2016; Dok.33 – Përberja e Qendres së Kërkimit Shkencor 2016-2019; Dok. 35 –Relacion i punës kërkimore shkencore 2011-2015; Dok. 36- Plan buxheti për veprimtarinë shkencore 2018-2019; dok.37- Formular i raportimit të stafit akademik për veprimtarinë shkencore] konstatojmë se:

1. Në detyrat e përcaktuara në Rregulloren e Qendrës së Kërkimit Shkencor pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara [Rregullore e Qendrës së Kërkimit Shkencor, Kreu III, neni 10, pika 2.b] citojmë: “Integrimin e veprimtarisë kërkimore me atë të mësimdhënies”.
2. Në misionin e saj [Rregullore e Qendrës së Kërkimit Shkencor] citojmë: “ Të realizojë me nivel të lartë shkencor dhe didaktik procesin mësimor”, dhe “Të mbështesë me veprimtaritë e veta procesin mësimor që zhvillohet në shkollë”.

GVJ pranon mendimin e KU “Logos” se prezenca e kërkimit shkencor në nivelin Bachelor për këtë program studimi është më e kufizuar, por ashtu sikur theksohet në detyrat e Rregullores së Qendrës së Kërkimit Shkencor dhe në detyrat që aktualisht ajo kryen [sikurse edhe theksohet nga KU “Logos” në komentet e tij] nuk gjejmë përpjekje të mbështetjes së punës së kësaj qendre në lidhje me programin e studimit.

#### **Konstatimi në draft-raport (fq. 14)**

GVJ pranon se kontratat e punës me afat të caktuar, të cilave u ka përfunduar afati, nuk bien ndesh me Ligjin Nr. 80/2015 dhe Kodin e Punës, duke qënë se ato konsiderohen si kontrata me afat të pacaktuar. Ky konstatim i GVJ u rishikua në draft RVJ.

#### **Konstatimi (fq 15)**

GVJ konstaton se stafi akademik me kohë të plotë është i mbingarkuar. Faktet janë dhënë në tabelat përkatese bashkëngjitur në aneksin e RVJ, dhe në dokumentin me titull “Shpërndarja e ngarkesës mësimore vjetore (2018-2019), Bsc Informatikë e Zbatuar” që u vu në dispozicion pas vizitës në Institucion. Në Udhëzimin e MASR Nr. 29 datë 10.09.2018, Kreu II, pika 1 citojmë: “Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë”. Po në këtë Udhëzim, Kreu II, pika 6 citojmë “Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndara në dy semester, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore”. Në Udhëzimin Nr. 37 datë 04.12.2018 pika 6 riformulohet citojmë “Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë përmban deri në 3 (tre) lëndë në semestër, në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë”.

GVJ ka konstatuar se ngarkesa mësimore vjetore arrin deri në 330 orë në auditor dhe 7 module semestrale. Nga ana tjetër, ky staf akademik ka gradën MSc. dhe është i ngarkuar edhe me përgatitjen për marrje të gradës “Doktor i Shkencave”. Për sa më sipër, bazuar në pikën 6 Udhëzimi Nr. 29 dhe 37 të MASR dhe në konstatimet në dokumentacion, GVJ është i mendimit se konstatimi i tij është i drejtë.

### **Konstatim (fq 16)**

Gjatë takimeve të zhvilluara GVJ konstatoi se disa zyra si Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë kishin ndryshuar varësinë e tyre institucionale dhe drejtimin. Konkretisht në takimin e zhvilluar me ZKK (Zj. Anisa Duka) citojmë: “Kam filluar punë në Dhjetor të 2018. Nuk ka patur më përpara këtë lloj zyrë Kolegji. Me riskstrukturimin e Kolegjit u pa e arësyeshme ngritja e kësaj zyre” [takim me ZKKS – faqe 1]. Megjithatë, duke shqyrtuar dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ ka konstatuar se ZKK është krijuar më parë se 2018, dhe se pohimi i bërë nga përfaqesuesja e ZKK nuk është i saktë. Në takimin me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë citojmë: “Kjo zyrë ka funksionuar me mënyra të ndryshme që nga licensimi i “Logos”, “Zyra ka patur disa ndryshime në varësi të strukturës së Kolegjit”.

Gjithashtu, gjatë takimeve u vu re se drejtuesit e zyrave të lartpërmendura nuk ishin në gjendje t’u përgjigjeshin shumë pyetjeve rreth periudhës para se të emëroheshin në ato pozicione, me arsyetimin se duke qenë të sapo emëruar, nuk e kishin informacionin e duhur. Pra, ndërkohë që ndryshimet mund të jenë kryer me synim për zhvillimin institucional dhe përmirësimin e cilësisë, GVJ gjykon se tranzicioni i menjëhershëm në drejtimin e këtyre strukturave ka sjellë problematika të shumta. Kjo evidentohet edhe nga grupi i vlerësimit të brendshëm si një nga pikat e dobëta të institucionit, ku citojmë: “Si një institucion i lartë, relativisht i ri, disa struktura të brendshme, janë ende të brishta” [RVB, fq. 105].

Për sa më sipër, GVJ është i mendimit që konstatimi i kryer nga ana e tij është i drejtë.

### **Konstatim (fq.22 dhe 23)**

GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacionin në lidhje me politikat për pasurimin e bibliotekës. GVJ ndërmori edhe vizitë në ambientet e bibliotekës. Në raport GVJ është munduar të theksojë se ekziston një mungesë investimi në lidhje me pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj dhe gjithashtu të përditësuar me hapin e kohës, të cilët i shërbejnë programit të studimit. GVJ i është referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga KU “Logos” para dhe pas vizitës në Institucion, në të cilin nuk arriti të gjejë evidencë për pasurimin e bibliotekës me libra të rinj në fushën e informatikës. Institucioni i paraqiti GVJ një dokument të ri bashkëngjitur komenteve ndaj draft RVJ, i cili është një listë e librave të rinj në fushën e informatikës, por duke qenë se ky dokument u paraqit pas hartimit të draft RVJ, ai nuk është marrë parasysh. Termi i përdorur



në “në fushën e inxhinierisë” nënkupton në fushën e programit të studimit dhe është zëvendësuar me “fushën e informatikës”.

#### **Konstatim (fq 27, 28)**

GVJ ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga Kolegji Universitar “Logos” dhe dokumentacionin shtesë të tij [dok.50: Metodologji Vlerësimi; Dok. 51: Info mbi rezultatet e pyetsorëve; Dok. 52: Procesverbal mbi zhvillimin e provimeve ( 2017-2018); Dok 53: Info e NJSBC mbi kontrollin e regjistrave; Dok. 55: Info e NJSBC mbi kontrollin e tezave të provimeve; dok. 56: Procesverbal mbi zhvillimin e pyetsorëve; Dok.57: Raporti Përmbledhës i NJSBC për vitin 2017-2018; dok.58: Procesverbal dijani pedagogut për vlerësimet; dhe dokumentacioni shtesë përkatësisht: dok.18: Formular vlerësimi nga studentët që diplomohen; dok.20: Formularët e NJSBC 2018-2019; dok.23: Politika e Sigurimit të Cilësisë; Dok. 24: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë; dok. 25: Modeli e formularit të Vlerësimit të stafit; Dok.26: Raporti i NJSBC për kontrollin e regjistrave].

Në këtë dokumentacion GVJ ka evidentuar si më poshtë vijon:

- a. Nuk ka asnjë të dhënë të përpunimit të pyetsorëve për vitet 2012-2017;
- b. Të dhënat në dok. 51: Info mbi të dhënat e pyetsorëve nuk japin të qartë grupin e studentëve, lënden e tyre dhe për këtë arsye edhe përpunimi statistikor i tyre është i paqartë. Të dhënat e paraqitura janë për semestrin e dytë, viti 2018 [datat 04.06.2018 dhe 06.06.2018].
- c. Në dokumentin nr.56: Procesverbal mbi zhvillimin e pyetsorëve jepen pyetsorë të datës 04.06.2018 dhe 06.06.2018 për katër pedagogë. Numri i studentëve të anketuar është 12. Në përfundim konkluzionet jepen nga NJSBC vetëm për një pedagog.
- d. GVJ nuk gjeti asnjë raport të NJSBC e cila përcakton në konkluzione pikat e forta dhe të dobëta të tij.

Për sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimet e zhvilluara GVJ është i mendimit që zyra e NJSBC kryen një punë serioze në këtë drejtim. Të dhënat e paraqitura nga GVJ janë të sakta dhe pasqyrojnë qartë punën e NJSBC në këtë institucion.

#### **Konstatim fq.29**

GVJ përmes dok. 58: Procesverbal dijani pedagogut për vlerësimin është në dijeni që rezultatet e pyetsorëve jepen në mënyre individuale. GVJ evidenton se nuk ka të dhëna të rezultateve të përpunuara të mbledhur nga pyetsorët për stafin administrativ. GVJ është vënë në dijeni dokumentit shtesë nr.20: Formularët e NJSBC për 2018-2019 të cilët japin strukturën e pyetsorit por aspak rezultat nga mbledhja e tyre. Në takimin e zhvilluar në Zyrën e Burimeve Njerëzore, drejtuesja e saj nuk na paraqiti dokumentacionin përkatës në këtë drejtim.

Për sa më sipër GVJ është i mendimit të mos ndryshojë formulimin e paraqitur në raport.

#### **Konstatim (fq 30, 31)**

GVJ duke ritheksuar edhe njëhere formulimin e bërë më sipër gjykon të drejtë konstatimin e tij.

#### **Konstatim (fq.33)**

GVJ rekomandon praktikën profesionale si kërkesë e dalë nga takimi me studentët. GVJ është i mendimit që ofrimi i praktikës profesionale sjell një përmirësim në aftësimin praktik të studentëve. GVJ vlerëson punën e bërë nga Institucioni në drejtim për përmbushjes së rekomandimeve të bëra nga Këshilli i Akreditimit, por në të njëjtën kohë ka në objektiv të punës së tij edhe dhënien e rekomandimeve të tjera aty ku GVJ shikon se ka mungesa apo dobësi.

GVJ e gjykon të drejtë formulimin e dhënë në RVJ për praktikën profesionale. GVJ e konsideron këtë rekomandim të drejtë bazuar kjo edhe në komentën e bërë nga Institucioni i cili e ka përcjellë këtë propozim edhe në MASR.

#### **Konstatim fq 37**

Konstatimi se “Norma (%) e totalit bazuar edhe në VKM nuk plotësohet në masën 2.2% për kategorinë B dhe në masën 2.8% tejkalon kufirin për kategorinë C” i referohet shpërndarjes aktuale, sic paraqitet në RVB dhe Planin Mësimor për vitin akademik 2018-2019. Pra, qëndron rekomandimi që duhet të rregullohet numri i krediteve në planin aktual mësimor, për lëndet në kategoritë B dhe C. GVJ e ka shqyrtuar vendimin e senatit akademik për përditësimin e programeve brenda normës 20%, dhe inkurajon vënien në zbatim të këtij vendimi, i cili i është përcjellë edhe MASR. Për këtë çështje, GVJ shtoi një referim të vendimit të senatit në RVJ ku thuhet se “synohet edhe korrigjimi i numrit të krediteve dhe përqindjeve sipas normave të VKM.

#### **Konstatim fq 39**

GVJ, bazuar edhe në Shtojcën Nr.2 të VKM nr.412 date 24.01.2018 është dakord me propozimin e institucionit për të hequr rekomandimin e bërë në këtë pikë.

#### **Konstatim (fq.41)**

Bazuar edhe në sqarimin e dhënë nga Institucioni, GVJ është i mendimit të shtojë edhe shtesën në formulim “për mungesë të pajisjes me regjistra themeltare nga QSHA”.

#### **Konstatim (fq. 43)**

Në gjykimin se aktivitetet e zhvilluara në kuadër të këshillimit të karrierës kanë qenë të pakta, GVJ u është referuar specifikisht aktiviteteve të këshillimit të karrierës, dhe jo të gjitha aktiviteteve studentore. Në këtë konstatim GVJ ka marrë parasysh edhe takimin në Institucion me përfaqësuesen e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillim Karriere, sipas të cilës, para emërimit të saj në dhjetor 2018 me çështjet e karrierës janë marrë pedagogët. Vlen të përmendet se kanë munguar më parë aktivitete të rëndësishme, sic është Panairi i Karrierës, i cili sipas Kalendarit të Aktiviteteve, planifikohet të organizohet për herë të parë gjatë vitit 2019. GVJ e ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur dhe nuk pretendon se aktivitetet për këshillimin e karrierës kanë munguar, por gjykon se këto aktivitete kanë qenë të pakta për nevojat e studentëve të programit “Informatikë e Zbatuar”.

## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit në Vendimin Nr. 338, datë 08.06.2012:

- 1) Të rishikohen programet e lëndëve si:
  - a. *Përpunim Teksti*
  - b. *Llogaritje të kompjuterizuara;*
  - c. *Përpunim imazhesh*
  - d. *Bazat e web design*
  - e. *Elemente të avancuar në web design*
- 2) Të rritet numri i personelit akademik me kohë të plotë;
- 3) Të rritet numri i personelit akademik me grada shkencore;

### II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- 1) **Për rekomandimin e parë** (Të rishikohen programet e lëndëve si: *Përpunim Teksti; Llogaritje të kompjuterizuara; Përpunim imazhesh; Bazat e web design; Elemente të avancuar në web design.*);

Departamenti Informatikë e Zbatuar në Kolegjin Universitar "Logos" ka ndërmarrë një sërë hapash në lidhje me përmbushjen e rekomandimit dhe në drejtim të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe takimet e zhvilluara me drejtues të Departamentit, stafin akademik dhe studentët rezultojnë se në këtë drejtim është ndjekur një politikë e duhur dhe janë zbatuar hapa konkretë.

Institucioni ndjek një politikë në lidhje me përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve në këtë program studimi. Përmirësimi është i bazuar në:

1. Monitorimi i programit përmes formave të kontrollit të stafit akademik organizuar nga Departamenti;
2. Raporti i NJSBC i formuluar nga anketimet e studentëve;
3. Zhvillimi teknologjik dhe kërkesat e tregut të punës (mbi baza individuale të stafit akademik dhe jo bazuar në një studim tregu nga institucioni ose departamenti);
4. Ngritja profesionale e stafit akademik (PAE dhe PAK) përmes pjesëmarrjes në konferenca / trajnime;
5. Përthithja e mendimit nga studentët aktualë dhe të diplomuar (alumni);

Konkretisht për lëndët e rekomanduara janë bërë rishikimet e përmbajtjes.

Në bazë të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 është ndryshuar kategoria e lëndëve:

- **Web Design** ka kaluar nga kategoria C në B;
- **Web Design** ka ndryshuar raportin e orëve (leksion: seminar: orë laboratorike) përkatësisht nga 1:0:2 në 1:1:1 duke theksuar edhe orët e seminareve sit ë rëndësishme;
- **Elemente të Avancuar në Web Design** ka ndryshuar raportin e orëve nga 2:0:2 në 2:1:1 duke i dhënë përparësi edhe orëve të seminareve.

Evidentojmë një ristrukturim të shpërndarjes së orëve në të tre vitet.

- Viti I: ka ndryshuar numrin total të orëve nga 720 në 690 orë;
- Viti II: ka ndryshuar numrin total të orëve nga 720 në 705 orë;
- Viti III: ka ndryshuar numrin total të orëve nga 765 në 720 orë.
- Programi i studimit ka një ndryshim të numrit total të orëve nga 2205 në 2115. Ky është një tregues i përmirësimit të kryer duke e bërë më efektive këtë program në drejtim të ngarkesës së tij kundrejt studentëve.

Ndryshimet e lartpërmendura janë brenda masës 20% të ndryshimeve të lejuara dhe shprehin një vullnet të Departamentit për përmirësime në programin mësimor. Nuk ka lëndë apo module që janë hequr apo janë shtuar në kurrikul. Ndryshimet konsistojnë në numrin e krediteve ECTS dhe orëve përkatëse për disa prej moduleve. GVJ mendon se këto ndryshime nuk i çënojnë qëllimet dhe objektivat e programit të studimit.

**Konkluzion:** GVJ në shqyrtimin e tij u bazua në dokumentacion e paraqitur dhe vizitën në Institucion. Theksuar për sa më sipër dhe në raport arrijmë në konkluzionin se janë bërë përmirësimet e duhura, programi i studimit vazhdon të jetë subjekt i përmirësimit dhe përditësimeve me zhvillimet bashkëkohore, prandaj **GVJ e konsideron këtë rekomandim të përmbushur.**

## 2) **Për rekomandimin e dytë** (Të rritet numri i personelit akademik me kohë të plotë);

Në kohën kur është dhënë ky rekomandim (në përfundim të vitit akademik 2011-2012), institucioni nuk angazhonte staf akademik me kohë të plotë (PAE) në programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”, por ai realizohej vetëm nga staf akademik me kohë të pjesshme (PAK).

Në funksion të këtij rekomandimi, institucioni ka filluar të angazhojë PAE që prej vitit akademik 2014-2015 [RVB, Tabelat 4]. Numri i stafit akademik efektiv ka pësuar ndryshime ndër vite.

Konkretisht:

Për vitin akademik **2012-2013 nuk ka patur** të angazhuar **PAE – 0%**, janë angazhuar **17 PAK – 100%** (3 Dr, 14 MSc);

Për vitin akademik **2013-2014 nuk ka patur** të angazhuar **PAE – 0%**, janë angazhuar **16 PAK – 100%** (3 Dr, 13 MSc);

Për vitin akademik **2014-2015** janë angazhuar **9 PAE – 75%** (2 Dr, 6 MSc, 1 Ba), dhe **3 PAK – 25%** (2 Prof. As., 1 MSc);

Për vitin akademik **2015-2016** janë angazhuar **8 PAE – 62%** (1 Prof. Dr., 1 Dr., 5 MSc, 1 Ba) dhe **5 PAK – 38%** (3 Prof. As., 2 MSc);

Për vitin akademik **2016-2017** janë angazhuar **8 PAE – 57%** (2 Prof. Dr., 6 MSc) dhe **6 PAK – 43%** (1 Prof. As., 1 PhD, 2 Dr., 2 MSc);

Për vitin akademik **2017-2018** janë angazhuar **7 PAE – 64%** (2 Prof. Dr., 5 MSc.) dhe **4 PAK – 36%** (1 Prof. As., 2 Dr. dhe 1 MSc.);

Për vitin akademik **2018-2019** angazhohen **4 PAE – 44%** (1 Prof. Dr., 3 MSc.) dhe **5 PAK – 56%** (1 Prof. As., 1 PhD, 1 Dr., 2 MSc.)

Raporti PAE/PAK në periudhën akademike 2012-2014 është zero, pasi nuk janë angazhuar staf akademik PAE. Përmirësime vihen re për periudhën akademike 2014-2017 ku numri i stafit PAE mbizotëron. Për vitin akademik 2017-2018 kemi rënie e cila rëndohet për vitin 2018-2019 në një reduktim në vetëm 4 personel akademik me kohë të plotë.

Për vitin akademik 2016-2017 numri i orëve të realizuara nga PAE është 1380 dhe PAK është 825 duke sjellë që **përqindja e orëve të realizuara nga PAE është në masën 62.6% dhe nga PAK 37.4%.**

Për vitin akademik 2017-2018 numri i orëve të realizuara nga PAE është 1380 dhe PAK është 735 duke sjellë që **përqindja e orëve të realizuara nga PAE është në masën 65.3% dhe nga PAK 34.7%.**

Për vitin akademik 2018-2019 numri i planifikuar i orëve të realizuara nga PAE është 1080 ndërsa për PAK është 810 dhe **përqindja e orëve të realizuar nga PAE rezulton të jete 57.1% shifër e cila nuk është në përputhje me standardin (70%) kurse nga PAK 42.9%.**

Për vitin 2018-2019 kemi edhe largim të stafit akademik me kohë të plotë. Nga takimet e zhvilluara u theksua se janë bërë përpjekje për të zëvendësuar personelin me kohë të plotë të larguar. Megjithatë, gjatë takimit me drejtuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore na u tha se aktualisht nuk ka shpallje për vende vakante për Departamentin Informatikë e Zbatuar, pasi nuk ka kërkesë për personel nga departamenti/fakulteti. Drejtuesja e Zyrës së Burimeve Njerëzore gjithashtu deklaroi se KU "LOGOS", duke patur statusin e Kolegjit Universitar dhe duke patur një numër studentësh më të vogël se 600, i ka dërguar një kërkesë ministrisë për të lidhur marrëveshje për përjashtimin nga kushtet e Pikës 4, të Nenit 25 të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në bazë të Pikës 7, të Nenit 17 të këtij ligji. **Kjo kërkesë nuk iu vu në dispozicion GVJ.**

**Konkluzion:** Me gjithë përpjekjet e Institucionit për rritjen e numrit të PAE gjatë periudhës 2013-2019, numri i stafit akademik më kohë të plotë është i pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me standardet e kërkuara. Bazuar për sa më sipër GVJ është i mendimit që ky rekomandim **është përmbushur vetëm pjesërisht nga ana e institucionit.**

3) **Për rekomandimin e tretë** (Të rritet numri i personelit akademik me grada shkencore);

Departamenti Informatikë e Zbatuar për vitin akademik 2018-2019 angazhon 1 Prof. Dr. dhe 3 MSc. Ky numër është i vogël. Ndonëse nga institucioni konstatuam përpjekje për rritjen e tij, shifrat janë të ulëta dhe nuk gjëjmë përmirësim në lidhje me këtë drejtim. Sic theksohet edhe më sipër kemi një rënie të numrit të stafit akademik në vite.

Numri i stafit akademik më kohë të plotë është i vogël dhe numri i gradave shkencore / titujve akademikë nuk është i lartë. Institucioni përpiqet t'i plotësojë këto mangësi me angazhimin e stafit akademik me kohë të pjesshme, ndër ta edhe me grada shkencore / tituj akademikë.

**Konkluzion:** GVJ është i mendimit që ky rekomandim është **përmbushur vetëm pjesërisht nga ana e institucionit.**

## ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

#### Pjesa përshkrimore

Misioni i programit të studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” është i reflektuar në Rregulloren e Departamentit Informatikë e Zbatuar [Aneksi 3/4: Rregullore e Departamentit “Informatike e Zbatuar”, 2018, neni 3 dhe 4]:

Ky program ka në misionin e tij:

- të formojë përgatitjen e specialistëve të informatikës me gjuhë programimi, teori dhe praktikë rrjetash kompjuterike, sisteme operative, grafike design, hardware dhe t’i bëjë ata të aftë për të punuar si në institucione shtetërore ashtu edhe ato private në përputhje me kërkesat e tregut.

Misioni lidhet:

- me garantimin e cilësisë dhe plotësimin e standardeve akademike, njihjen me risitë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe pasqyrimin në programet e studimit;
- me nxitjen, mbështetjen dhe zhvillimin e aktivitetit shkencor të pedagogëve dhe studentëve, veçanërisht atyre diplomatë;
- me bashkëpunimin me subjektet zbatuese / kërkimore për identifikimin e kërkesës për specialistë në fushën e informatikës dhe përshtatjen e programeve mësimore në funksion të tyre;
- me aftësimin praktik të studentëve dhe veçanërisht studentëve diplomatë.

Referuar takimeve të zhvilluara konstatojmë se misioni i programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” synon t’u ofrojë të diplomuarve një diplomë universitare, arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional, të përshtatje me kërkesat e tregut të punës.

Referuar Rregullores së Programit, programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” ka si objektiv përgatitjen teoriko-praktike të studentëve më njohuritë bazë të disiplinave informatike të zbatuara që mundësojnë një formim të shëndoshë të studentit nëpërmjet fitimit të shkathtësive teoriko-praktike të tilla që ai të jetë i aftë për të zhvilluar softuerë aplikativë në fusha të ndryshme të lidhura me kërkesat e ekonomisë të tregut ose institucioneve në përputhje me teknologjitë më të avancuara të informacionit të mbështetura në administrimin e rrjetave dhe Webit [Aneksi 3/5: Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” në Informatikë e zbatuar, neni 12, pika 4].

Programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” realizohet me 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatja e tij normale është 3 vjet. Një kredit përkon me 25 orë punë të studentit, përfshirë këtu edhe orët e punës së pavarur. Plani dhe programi mësimor detajohen në dokumentat e Aneksit 4/1, të cilat i janë vënë në dispozicion GVJ.

Funksionimi i programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” udhëhiqet nga një rregullore në nivel programi [Aneksi 3/5: Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” në Informatikë e zbatuar], si dhe Rregullores në nivel institucional [Aneksi 3/2: Rregullore e Përgjithshme e KU “Logos”]. Edhe pse nuk ekziston një dokument për Strategjinë e Programit, institucioni ka hartuar plane strategjike në nivel institucional, për periudhat 2012-2017 dhe 2018-2024 [Aneksi 3/3: Plani Strategjik i Zhvillimit të SHLP Logos 2012-2017], [dok: Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2024].

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	

<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ mendon se programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, të përcaktuar në Nenin 3 të Statutit [Aneksi 3/1]. Misioni, qëllimi dhe objektivat e programit të studimit janë të përcaktuara kryesisht në Rregulloren e Departamentit Informatikë e Zbatuar [Aneksi 3/4, neni 3 dhe 4] dhe më pak në Rregulloren e Programit të studimit [Aneksi 3/5, neni 12, pika 4]. Gjithashtu misioni, qëllimi dhe objektivat e programit paraqiten të riformuluara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm [RVB, faqe 8], por nuk është e qartë nëse këtu raporti i referohet ndonjërit prej dokumentave bazë të institucionit. GVJ rekomandon që qëllimet dhe objektivat e programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” të saktësohen më të detajuara në Rregulloren e Programit, përta i përket dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale (fushave të punësimit) që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit.</p> <p>GVJ është i mendimit se objektivat e reflektuara në Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Programit, përputhen me planin dhe programin mësimor të programit, të detajuar në seksionin 7.</p> <p>Programi “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”, duke synuar të përgatisë specialistë të fushave të ndryshme të informatikës (<i>Specialistë IT për strukturat e sistemit bankar dhe administrative; Zhvillues aplikacionesh web dhe desktop; Specialistë rrjetesh kompjuterike; Administrues sistemesh operimi</i>), është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, ku sektori i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit zë një vend mjaft të rëndësishëm.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Grupit të Vlerësimit të Jashtëm nuk i është vënë në dispozicion një Strategji Zhvillimi në nivel programi, megjithëse është hartuar një strategji e tillë në nivel institucional. Kjo e fundit liston gjashtë prioritetet të përgjithshme strategjike:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvillimi institucional</li> <li>2. Përmbytja e standardeve akademike të përsosmërisë</li> <li>3. Kërkimi</li> <li>4. Ndërtimi i partneritetit</li> <li>5. Ndërkombëtarizimi</li> <li>6. Sigurimi i cilësisë</li> </ol> <p>Programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” nuk bie ndesh me prioritetet e mësipërme, por i ndihmon ato në mënyrë direkte ose indirekte.</p> <p>Referuar vizitës në institucion dhe rregullores së departamentit dhe programit të studimit, ky program synon pajisjen me njohuritë profesionale dhe shkencore të studentëve dhe të përgatisë specialistë të aftë për zgjidhjen e problemeve nëpërmjet programeve kompjuterike. Konkretisht, synohet të përgatiten një llojshmëri e gjerë specialistësh si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Specialistë IT për strukturat e sistemit bankar dhe administrative;</li> <li>• Zhvillues aplikacionesh web dhe desktop;</li> <li>• Specialistë rrjetesh kompjuterike;</li> <li>• Administrues sistemesh operimi;</li> </ul>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e prishëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Programi i studimit synon në plotësimin e kërkesave të tregut të punës dhe ndjekjen e tendencave të zhvillimit. Megjithatë, ndonëse anëtarët e personelit akademik të programit bazohen në përvojën e tyre dhe ruajnë kontakte informale me aktorë të biznesit dhe me të diplomuarit e këtij programi, gjatë vizitës në institucion u <u>evidentua se institucioni apo departamenti nuk ka kryer një studim të mirëfilltë të tregut të punës. Rekomandojmë të ndërmerret një studim tregu për këtë profil studimi.</u></p>
<p><b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Në bazë të misionit dhe objektivave të këtij programi studimi, të cilat u përmendën më sipër, nuk ka pika ku ky program bie ndesh me interesat kombëtare. Nëpërmjet formimit të specialistëve në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” ka potencialin të ndihmojë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p>	
<p>GVJ gjykon se programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” është hartuar në përputhje me misionin, qëllimin, dhe strategjinë e zhvillimit të KU “LOGOS”.</p> <p>GVJ konstaton se institucioni nuk ka kryer një studim të tregut të punës për hartimin apo për përditësimin e programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”. <b>GVJ rekomandon të ndërmerret një studim tregu për këtë profil studimi.</b></p> <p>GVJ gjykon se programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” nuk bie ndesh me vlerat kulturore apo interesat kombëtare. Përkundrazi, ky program studimi mund të ndihmojë drejt zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit duke përgatitur ekspertë të rinj në sektorin e TIK.</p>	



## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

Kolegji Universitar "LOGOS" përbëhet nga tre fakultete [dok 21: Rregullore e Përgjithshme e Logos; Vendimi; Urdhër Nr. 408, datë 13.07.2018 i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë]

- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara
- Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor

Programi i studimit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara. Ky Fakultet përbëhet nga tre njësi si vijon më poshtë:

#### **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara**

1. Departamenti Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë
2. Departamenti Informatikë e Zbatuar
3. Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit (FSHA)

Ky program ofrohet në Departamentin Informatikë e Zbatuar e cila është njësi bazë mësimore dhe kërkimore detyrat e të cilës janë të shprehura në Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit dhe në Rregulloren e Programit [Dok. 24: Rregullore e Departamentit Korrik 2016, Dok.25: Rregullore e programit Korrik 2018].

**Departamenti Informatikë e Zbatuar** kryen mbarëvajtjen e procesit mësimor në Ciklin e parë të studimeve: "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" (me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe 180 kredite. Departamenti siç theksohet edhe në Statut dhe në Rregulloren e tij ka në bazën e veprimtarisë së tij ndjekjen e politikave që kanë të bëjnë me sigurimin e programit të studimit, mbarëvajtjes së procesit mësimor, monitorimin e politikave në lidhje me përmirësimet në metodiken mësimore nga ana e stafit akademik, mbështetjen e tij në kërkimin shkencor dhe monitorimin e performancës përmes bashkëpunimit me NJSBC.

Për vitin akademik 2012-2013 nuk ka patur të angazuar PAE – 0%, janë angazhuar 17 PAK – 100% (3 Dr, 14 MSC);

Për vitin akademik 2013-2014 nuk ka patur të angazuar PAE – 0%, janë angazhuar 16 PAK – 100% (3 Dr, 13 MSC);

Për vitin akademik 2014-2015 janë angazhuar 9 PAE – 75% (2 Dr, 6 MSc, 1 Ba), dhe 3 PAK – 25% (2 Prof. As., 1 MSc);

Për vitin akademik 2015-2016 janë angazhuar 8 PAE – 62% (1 Prof. Dr., 1 Dr., 5 MSc, 1 Ba) dhe 5 PAK – 38% (3 Prof. As., 2 MSc);

Për vitin akademik 2016-2017 janë angazhuar 8 PAE – 57% (2 Prof. Dr., 6 MSc) dhe 6 PAK – 43% (1 Prof. As., 1 PhD, 2 Dr., 2 MSc);


Për vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar 7 PAE – 64% (2 Prof. Dr., 5 MSc.) dhe 4 PAK – 36% (1 Prof. As., 2 Dr. dhe 1 MSc.);

Për vitin akademik 2018-2019 angazhohen 4 PAE – 44% (1 Prof. Dr., 3 MSc.) dhe 5 PAK – 56% (1 Prof. As., 1 PhD, 1 Dr., 2 MSc.)

Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

**Struktura akademike e Fakultetit**



Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ka në strukturën e tij staf akademik me grada shkencore. Për vitin akademik 2017 – 2018 në përbërjen e tij janë angazhuar 19 pedagoge si staf efektiv PAE, 9 si PAK dhe 3 si PA. Në total janë angazhuar 31 pegagogë për programet e studimit që ofrohen në këtë fakultet.

**Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës**

Departamenti Informatikë e Zbatuar ka një strukturë akademike e cila ka pësuar luhatje në vite. Për vitin akademik 2012-2013 dhe 2013-2014 ky program studimi është mbuluar vetëm nga staf akademik me kohë të pjesshme ( 3 Dr., 14 MSc.; 3 Dr. 13 MSc.) Departamenti ka bërë përpjekje për rritje të stafit më kohë të plotë. GVJ evidenton dëshmi të rritjes së këtij numri përkatësisht për periudhën 2014 -2018 ku numri i PAE mbizotëron në këtë program me një përqindje mesatarisht 64.5% dhe me grada shkencore Dr. dhe MSc. Gjatë vitit 2018-2019 GVJ konstaton një rënie të numrit të stafit akademik (vetëm 4 PAE janë angazhuar në këtë program studimi) e cila është shoqëruar edhe me një mbingarkesë të tij [të dhëna të detajuar janë pasqyruar në tabelën 5 në aneks].

Stafi akademik për këtë program studimi është i vogël dhe me grada MSc. Gjejmë përpjekje të departamentit për të angazhuar staf akademik me kohë të pjesshme dhe me eksperiencë. Kryesisht ata punojnë me kohë të plotë në universitete shtetërore (1 UAMD, 2 FSHN) si edhe përfshirjen e stafit akademik PAK nga komuniteti i biznesit (1 IKUB). Bazuar në aktet ligjore në fuqi dhe në Rregulloren e Departamenti Informatikë e Zbatuar [dok.25 – Rregullore e Departamentit Informatikë e Zbatuar, neni 6] citojmë:

*“Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me grada dhe tituj”*

**Vlerësojmë që ky Departament nuk përmbush kriterin për një staf akademik efektiv me grada shkencore dhe me numër të konsiderueshëm për të përmbushur standardin për mësimdhënie. Rekomandojmë që Institucioni duhet të zhvillojë një politikë më intensive në lidhje me shtimin e stafit akademik efektiv dhe përthithjen e një stafi me grada të duhura shkencore.**

Ne Fakultetin e Shkencave të Aplikuara si njësi e tretë është edhe Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit (FSHA) për të cilën nuk gjejmë evidenca të plotë të mbështetjes që ajo jep për këtë program studimi. Rekomandojmë një koordinim të punës së saj në mbështetje të Departamentit Informatikë e Zbatuar.

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

Bazuar në organigramën e vënë në dispozicion nga KU "LOGOS", njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" është **Departamenti Informatikë e Zbatuar**, kurse njësia kryesore përgjegjëse është **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara**.

Në vitin akademik 2013-2014, institucioni nuk ka angazhuar asnjë personel akademik me kohë të plotë (PAE) në programin e studimit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar", pasi mësimdhënia realizohej vetëm me personel me kohë të pjesshme (PAK). Duke filluar nga viti akademik 2014-2015, janë angazhuar edhe personel akademik me kohë të plotë (PAE) në këtë program studimi, por ky numër ka pësuar rënie të vazhdueshme, sidomos gjatë tre viteve të fundit. Aktualisht, për vitin akademik 2018-2019 janë gjithsesj 4 PAE, 1 prej të cilëve me titullin Prof. Dr. dhe 3 prej tyre me gradën MSc [**Tabela 2 në aneks**]. Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se tre prej anëtarëve të PAE janë larguar në fillim të vitit akademik 2018-2019 duke e ulur numrin e PAE nga 7 në 4. Rrjedhimisht, një pjesë e ngarkesës mësimore e personelit të sapo larguar u është kaluar personelit ekzistues me kohë të plotë, duke e rritur më tej ngarkesën e tyre mësimore.

Dekania e fakultetit dhe drejtuesi i departamentit, gjatë takimit me GVJ, thanë se po bëhen përpjekje për t'a zëvendësuar personelin me kohë të plotë që është larguar. Megjithatë, gjatë takimit me drejtuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore, u pohua prej saj se aktualisht nuk ka shpallje për vende vakante për Departamentin Informatikë e Zbatuar, pasi nuk ka një kërkesë për personel nga ana e departamentit / fakultetit. Gjithashtu, drejtuesja e Zyrës së Burimeve Njerëzore deklaroi se KU "LOGOS", duke patur statusin e Kolegjit Universitar dhe duke patur një numër studentësh më të vogël se 600, i ka dërguar një kërkesë ministrisë për të lidhur marrëveshje për përjashtimin nga kushtet e Pikës 4, të Nenit 25 të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", në bazë të Pikës 7, të Nenit 17 të këtij ligji. Megjithatë, **një kërkesë e tillë nuk iu vu në dispozicion GVJ nga institucioni**.

GVJ verifikoi gjatë takimit me Zyrën e Burimeve Njerëzore dy dosje të personelit akademik, të përzgjedhura në mënyrë rastësore: një dosje për personelin me kohë të plotë dhe një dosje për personelin me kohë të pjesshme. Këto dosje përmbanin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ku përfshihen:

- Kontrata e punësimit
- Curriculum Vitae
- Diplomat përkatëse të noterizuara dhe të njehsuara
- Dëftesat e notave
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore
- Vërtetim gjuhësh të huaja
- Certifikata trajnimesh, konferencash, botimesh, etj.

Takimi i GVJ me anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme u zhvillua sipas agjendës. Diskutimi u orientua rreth ngarkesës mësimore dhe të përgjithshme, formave të mësimdhënies dhe vlerësimit, komunikimit me studentët, sigurimit të cilësisë, zhvillimit të mëtejshëm profesional, etj.

Kriteri ligjor i mbulimit të mbi 70% të ngarkesës mësimore (bazuar mbi numrin e orëve në auditor) nga personeli akademik me kohë të plotë (PAE) nuk përmbushet për dy vitet e fundit akademike (2017-2018 dhe 2018-2019) (shih më poshtë).

Për vitin akademik 2018-2019, ngarkesa mësimore e personelit akademik me kohë të plotë paraqitet në dokumentin [dok. "**Ngarkesa mësimore 2018-2019**"], i cili u vu në dispozicion nga drejtuesja e Zyrës së Burimeve Njerëzore pas vizitës në institucion. Vihet re se për këtë vit akademik ngarkesa mësimore vjetore arrin deri në 330 orë në auditor dhe 7 module semestrale.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK),** bashkë me titujt/gradat, për çdo vit akademik janë paraqitur në Tabelat 4 në aneks.

- Për vitin akademik 2013-2014, raporti PAE/PAK është **0/16**.
- Për vitin akademik 2014-2015, raporti PAE/PAK është **9/3**.
- Për vitin akademik 2015-2016, raporti PAE/PAK është **8/5**.
- Për vitin akademik 2016-2017, raporti PAE/PAK është **8/6**.
- Për vitin akademik 2017-2018, raporti PAE/PAK është **7/4**.
- Për vitin akademik 2018-2019, raporti PAE/PAK është **4/5**.

Mendimi i GVJ është se këto raporte janë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, përveç vitit të fundit akademik, ku vihet re një mungesë e personelit akademik me kohë të plotë.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre.**

Të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre paraqiten në Tabelat 5 në aneks.

**Gjatë vitit akademik 2013-2014** u angazhuan **0 PAE** me tituj; dhe **3 Doktorë** si **PAK**.

**Gjatë vitit akademik 2014-2015** u angazhuan **2 Doktorë** si **PAE**; dhe **2 Prof. As.** si **PAK**.

**Gjatë vitit akademik 2015-2016** u angazhuan **1 Prof. Dr.** dhe **1 Doktor** si **PAE**; dhe **1 Prof. As.** si **PAK**.

**Gjatë vitit akademik 2016-2017** u angazhuan **2 Prof. Dr.** si **PAE**, dhe **1 Prof. As.** dhe **3 Doktorë** si **PAK**.

**Gjatë vitit akademik 2017-2018** u angazhuan **2 Prof. Dr.** si **PAE**, dhe **1 Prof. As.** dhe **3 Doktorë** si **PAK**.

**Gjatë vitit akademik aktual 2018-2019**, angazhohet **1 Prof. Dr.** si **PAE**, dhe **1 Prof. As.** dhe **2 Doktorë** si **PAK**. Megjithëse numri total i personelit akademik me grada shkencore ose tituj akademikë të angazhuar në program (PAE + PAK) konsiderohet i arsyeshëm (**4**), vetëm **1** prej tyre është me kohë të plotë. GVJ mendon se ky numër është i pamjaftueshëm për nevojat e programit të studimit.

- Të dhënat sipas seksit**

Nuk ka.

- Të dhëna sipas moshës së personelit**

Të dhënat sipas moshës paraqiten në Tabelat 6 në aneks. Vihet re një përzjerje e stafit me moshë të re dhe pa tituj akademikë, dhe e stafit me moshë më të vjetër dhe me tituj akademikë.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

GVJ arrin në konkluzionin se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme është i pajisur me kontrata pune të rregullta, në përputhje me kodin e punës. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se ende nuk ishin firmosur kontratat me afat 1 vjeçar për personelin akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2018-2019. GVJ i është vënë në dispozicion një shembull i kontratës së stafit me kohë të plotë [Aneksi 5/6: Kontrata e punës së pedagogut me kohë të plotë] dhe një shembull i kontratës së stafit me kohë të pjesshme [Aneksi 5/7: Kontrata e punës së pedagogut me kohë të pjesshme].

Edhe pse në RVB nuk përmendet për Zyrë për Burimet Njerëzore, gjatë vizitës në institucion GVJ zhvilloi një takim me drejtuesen e burimeve njerëzore, e cila shërbente në këtë pozicion që prej dhjetorit 2018. Diskutimi u zhvillua rreth procedurës së rekrutimit të stafit akademik dhe kritereve të përzgjedhjes. U vu re

një mospërputhje midis procedurave të rekrutimit të përshkruara në dokumentacion [**Aneksi 5/3: Praktikë Rekrutimi Stafi Akademik Info e Zbatuar**] dhe atyre të përshkruara nga drejtuesja e Zyrës së Burimeve Njerëzore. Megjithatë, GVJ arrin në konkluzionin se institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit akademik.

**Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë**

Sipas Tabelës 1 në aneks, numri i personelit administrativ për Departamentin Informatikë e Zbatuar është 1, kurse për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara është 3.

Vihet re se stafi ndihmës / administrativ angazhohet kryesisht në nivel institucional dhe vepron për të gjitha programet e studimit [**vizita në institucion**]. Gjatë vizitës u konstatua gjithashtu një paqëndrueshmëri në përbërjen e disa zyrave për shkak të ndërrimit të stafit administrativ kohët e fundit, siç ishte drejtuesja e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës (prej dhjetorit 2018), drejtuesja e Zyrës së Burimeve Njerëzore (prej dhjetorit 2018), dhe drejtuesja e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë (prej 1 viti e gjysëm).

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

- Ngarkesa mësimore 2018-2019 e stafit të angazhuar në programin e studimit.
- Stafi i programit të studimit për vitin akademik 2018-2019.
- Procedura e rekrutimit për staf akademik të brendshëm e të jashtëm
- Plani mesimor, Syllabuset 2018-2019 të përditësuara

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Institucioni ka një drejtuese / Zyrë të Burimeve Njerëzore që angazhohet me procedurat e rekrutimit dhe ruajtjen e dosjeve të personelit [<b>takimi me drejtuesen e burimeve njerëzore</b>]. Përzgjedhja e personelit kryhet nga komisione ad-hoc të ngritura nga dekanët e fakulteteve përkatëse, kurse kriteret e përzgjedhjes paraqiten në njoftimet përkatëse për punë. Dokumentacioni që i është vënë në dispozicion GVJ mbi raportet e rekrutimit të personelit në të kaluarën [<b>Aneksi 5/3: Praktikë Rekrutimi Stafi Akademik Info e Zbatuar</b>] paraqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kërkesën për ngritjen e komisioneve ad-hoc për disa vende vakante</li> <li>• përbërjen e komisioneve ad-hoc</li> <li>• raportin e propozimit për pedagogë të jashtëm nga komisioni ad-hoc.</li> </ul> <p>Gjithashtu, pas vizitës së GVJ, u vu në dispozicion dokumentacion shtesë [<b>dok. "Procedura e rekrutimit për staf akademik të brendshëm e të jashtëm"</b>], ku paraqitet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shembull kërkesë për personel nga dekanit</li> <li>• njoftimi për punë</li> <li>• raport mbi përzgjedhjen e aplikantëve sipas një sistemi transparent pikësh</li> <li>• evidencë e organizimit të intervistave të punës.</li> </ul>

	<p>Theksojmë se ky dokument u referohet vendeve vakante në Fakultetin e Ekonomisë, por GVJ merr të mirëqenë se procedura të ngjashme janë ndjekur edhe në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara. Si rezultat, GVJ mendon se procedurat e përshkruara në dokumentacion janë transparente dhe ligjore.</p> <p>Për sa i përket kriterit që personeli akademik me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar në program, GVJ ka llogaritur orët e realizuara në auditor nga PAE dhe orët e realizuara nga PAK. Në përlllogaritjen e orëve, është marrë për bazë versioni i Tabelës 13 me modulet dhe pedagogët përkatës (jo me lëndët dhe titullarët përkatës), pasi ky version reflekton ngarkesën reale mësimore. Si rezultat, për vitin akademik 2017-2018, numri i orëve të realizuara nga PAE është <b>1380</b>, nga PAK është <b>735</b>, dhe përqindja e orëve të realizuara nga PAE rezulton të jetë <b>65.2%</b>. Për vitin akademik 2018-2019, numri (i planifikuar) i orëve të realizuara nga PAE është <b>1080</b>, nga PAK është <b>810</b>, dhe përqindja e orëve të realizuara nga PAE rezulton të jetë <b>57.1%</b>. Pra kriteri nuk përmbushet, edhe pse shifrat nuk janë shumë larg pragut 70%. Rekomandohet që departamenti ta rishikojë planin mësimor për vitet akademike në vazhdim, duke angazhuar më shumë personel akademik me kohë të plotë.</p> <p>Personeli akademik vlerësohet kryesisht nga studentët nëpërmjet formularit të vlerësimit, si dhe nga drejtuesi i departamentit, nëpërmjet formularit të vlerësimit të stafit nga pergjegjesi i departamentit dhe auditeve gjatë orëve mësimore. Metodologjia e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë detajohen më tej në seksionin 6: Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor., ose titullin akademik “Docent,...</p>	<p>Drejtuesi i Zyrës së Burimeve Njerëzore mban të dhëna të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të angazhuar në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, të cilat ruhen në dosjet përkatëse për secilin anëtar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.</p> <p>Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ. U vunë re disa mospërputhje në lidhje me titullarët e lëndëve mes Tabelave 13 dhe dokumentacionit, sic ishte [<b>Aneksi 4/1: “Plani mesimor, Syllabuset 2018-2019”</b>]. Këto mospërputhje u korrigjuan në versionin e ri të këtij aneksi, i cili u vu në dispozicion pas vizitës në institucion. Vihet re gjithashtu për disa lëndë se pedagogu titullar i lëndës mund të mos angazhohet në mësimdhënie në asnjë prej moduleve përbërëse të lëndës. Si rrjedhojë, versioni i Tabelave 13 që reflekton ngarkesën mësimore të personelit akademik, është ai i ndarë sipas moduleve dhe jo sipas lëndëve.</p> <p>Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik, kryesisht nëpërmjet shpalljeve për vendet vakante në web (<a href="http://www.kulogos.edu.al">www.kulogos.edu.al</a>) dhe rrjete sociale. Procedurat për Departamentin Informatikë e Zbatuar gjithashtu përmbledhen në [<b>Aneksi 5/3: Praktike Rekrutimi Stafit Akademik Info e Zbatuar</b>].</p> <p>Sic paraqitet në Tabelat 4 dhe 13, institucioni ka angazhuar si titullarë të lëndëve/moduleve, edhe personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor”. Ndër ta ka edhe titullarë me grada më të larta, si Prof. As. dhe Prof. Dr.</p>
<p><b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen</p>	<p>Orët laboratorike të programit janë realizuar përgjithësisht nga pedagogët përkatës të moduleve. Për mirëmbajtjen e laboratorëve</p>

<p>e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>dhe mjediseve shkollore, gjithashtu institucioni ka angazhuar staf ndihmës dhe administrativ, në nivel institucional. Gjatë vizitës së GVJ u evidentua se institucioni kishte caktuar personel përgjegjës për laboratorët kompjuterikë dhe çështje të tjera të teknologjisë së informacionit <b>[vizita në institucion]</b>.</p> <p>Personeli akademik si me kohë të plotë, ashtu edhe të pjesshme, është i angazhuar për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Ngarkesa mësimore caktohet në shtojcën e kontratës së punës. Për vitin akademik 2018-2019, ngarkesa mësimore e personelit akademik me kohë të plotë paraqitet në dokumentin <b>[dok. “Ngarkesa mësimore 2018-2019”]</b>, i cili u vu në dispozicion nga drejtuesja e Zyrës së Burimeve Njerëzore pas vizitës në institucion. Vihet re se për këtë vit akademik ngarkesa mësimore vjetore arrin deri në <b>330 orë</b> në auditor dhe <b>7 module</b> semestrale. Dy anëtarë të PAE në departamentin Informatikë e Zbatuar janë gjithashtu të angazhuar në mësimdhënie në lëndët Informatikë I dhe II në programe të departamenteve të tjera. Sic u theksua te pjesa përshkrimore, vihen re mungesa në personelin akademik me kohë të plotë në departamentin Informatikë e Zbatuar, të cilët aktualisht janë gjithsej <b>4</b>, prej të cilëve vetëm <b>1</b> me gradë/titull (Prof. Dr.).</p> <p>Programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” nuk parashikon praktikë profesionale <b>[Tabela 10 e aneksit]</b>.</p>
<p><b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>KU “LOGOS” i ka ofruar stafit akademik disa programe për kualifikimin e mëtejshëm profesional, sic dëshmohet në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga zyra e marrëdhënieve me jashtë <b>[dok: “Programi Erasmus+, Marreveshje, thirrje, aktivitete”]</b>, <b>[dok: “Trajtime te stafit akademik per projekte nderkombetare”]</b>. Një numër i kufizuar i trajnimeve janë zhvilluar edhe jashtë vendit, si vizita e tre anëtarëve të personelit akademik në Universitetin e Maqedonisë Perëndimore, Kozan, Greqi, dhe pjesëmarrja e një grupi studentësh dhe stafi akademik nga Departamenti Informatikë e Zbatuar në festivalin arsimit “Spoudase 2018” në Universitetin e Pireut, Greqi. Aktualisht, sipas zyrës së marrëdhënieve me jashtë, buxheti i akorduar nga KU “LOGOS” për pjesëmarrje në trajnime / konferenca jashtë vendit është 600 €/vit/departament, megjithëse deri tani nuk ka përfutur asnjë anëtar i personelit akademik të Departamentit Informatikë e Zbatuar nga ky fond <b>[takimi me zyrën e marrëdhënieve me jashtë]</b>.</p> <p>Institucioni disponon një dosje të plotë për të gjitha programet e studimit të ofruara në KU “LOGOS”. Në këtë dosje përfshihet Aneksi 4/1: “Programi Informatike e Zbatuar 2018”, i cili përmban të gjitha silabuset e përditësuara të lëndëve të programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>GVJ gjykon se KU “LOGOS” ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</p> <p>GVJ konstaton se për vitin akademik 2018-2019, departamenti përgjegjës për programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” nuk i përmbush kriteret e Nenit 25, të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka në përbërjen e tij vetëm 4 anëtarë, prej të cilëve vetëm 1 me gradë shkencore ose titull akademik.</p> <p>GVJ konstaton se për programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”, ngarkesa mësimore e mbuluar nga personeli akademik efektiv (PAE) përbën më pak se 70%. Mungesën e personelit akademik efektiv (PAE), institucioni përpiqet ta plotësojë me personel akademik me kontratë (PAK), ndër të cilët edhe pedagogë me grada shkencore ose tituj akademikë. <b>Rekomandohet që departamenti të angazhojë më shumë PAE në këtë program studimi.</b></p> <p>GVJ konstaton se dosjet e personelit akademik (PAE dhe PAK) të angazhuar në këtë program studimi janë të plota, me të</p>	

gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

GVJ vë re se një pjesë e personelit akademik me kohë të plotë është i mbingarkuar në mësimdhënie, ku ngarkesa vjetore arrin deri në 330 orë në auditor dhe 7 module të ndryshme semestrale. **GVJ rekomandon uljen e kësaj ngarkese në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe outputit shkencor të personelit akademik me kohë të plotë.**

GVJ gjykon se KU "LOGOS" është angazhuar për zhvillimin e mëtejshëm të personelit akademik, kryesisht në formën e trajnimeve brenda vendit, dhe më pak jashtë vendit, në bashkëpunim me universitete partnere.





#### 4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

##### Pjesa përshkrimore

Kolegji Universitar "LOGOS" ka në vëmendjen e tij përmirësimin e infrastrukturës. Pasuria në pronësi dhe paprekshmëria e saj i gjejnë të shprehur në Statut [dok.19: Statut i Kolegjit Universitar "LOGOS", neni 6]. Kolegji Universitar "Logos" i zhvillon programet e saj të studimit në pallatet "Komfort" mbi bazën e kontratave të huapërdorjes të lidhur midis shoqërisë "Komfort" shpk dhe Kishës Othodokse Autoqefale të Shqipërisë [dok. 6: Kontrate huapërdorje date 21.02.2015; dok.7: Kontratë huapërdorje datë 01.07.2018; dok.8: kontratë huapërdorje date 24.04.2016].

Godina në shërbim të Institucionit ka një infrastrukturë të duhur për të zhvilluar programin e studimit. GVJ u mbështet në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni dhe në vizitat [në përputhje me agjendën] që u zhvilluan në ambjentet e saj. Godina ku zhvillohet programi i studimit është e ndërtuar në akordancë me kushtet teknike të ndërtimit dhe të zbatimit. Sallat e leksioneve, laboratorët dhe sallat e seminareve janë të ndriçuara mirë sipas normativave teknike të kërkuara. Godina është e pajisur me ashensor dhe shkallë të emergjencës. Skema e evakuimit është e vendosur në çdo kat të saj. Përveç ambjenteve mësimore janë siguruar edhe zyrat për stafin akademik dhe personelin ndihmës të tij. Studentët kanë edhe ambiente rekreative (bar , palester etj). Godina është e pajisur me burime alternative të furnizimit me ujë ( katër depozita me nga 5 tonë), si dhe burime alternative të furnizimit me energji elektrike (gjenerator). Godina është e pajisur me sistem ngrohje qendrore me kaldajë për të gjitha mjediset, si dhe me mjetet e nevojshme për mbrotjen kundra zjarrit. Për rastet emergjence godina siguron dy dalje [RVB per vitin 2017-2018].

Institucioni, si pjese e Fondacionit "Logos", përdor asete për zhvillimin e veprimtarisë së tij, menaxhimi i të cilave bëhet mbi bazën e evidentimit fizik dhe financiar, mirëmbajtjes, lëvizjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të tyre. Evidentimi i aseteve nëpërmjet programit Financa 5, është mënyra e ndjekjes dhe vlerësimit të gjendjes dhe amortizimit të tyre. Institucioni, në mënyrë periodike, organizon inventarin fizik të aseteve, i cili kryhet nga një komision i ngritur për këtë qëllim. Është punuar për kodifikimin e aseteve dhe rifreskimin e etiketimit të tyre [RVB për vitin 2017-2018].

Në dispozicion të programit të studimit dhe të studentëve në përputhje me nevojat e tyre janë vënë: salla leksioni, seminari të pajisura me projektor dhe laptop, laboratore informatike për zhvillimin e procesit mësimor, sallë konferencash e pajisur me mjete komunikimi pamore, dëgjimore, multimediale, zyra dhe teknologji informimi për stafin akademik. Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtashme për mësimdhënie në përputhje me standartet dhe kërkesat që një IAL duhet të plotësojë.

Për programin e studimit janë vënë në dispozicion 4 laboratore të pajisur me programet e duhura. GVJ bëri një vizitë në këto laboratore dhe gjejnë një përputhshmëri midis dokumentacionit të dorëzuar dhe gjendjes aktuale në këtë institucion.

- Laboratori Nr.3 (kati 7) ka 9 PC. Ky laborator përdoret për nevojat e departamentit dhe për lëndën e Financës për programet e studimit me fushë ekonomike.
- Laboratori Nr. 2 (kati 6) ka 15 PC.
- Laboratori Nr. 1 (kati 6) ka 15 PC. Përdoret për programin e studimit të Departamentit Informatikë e Zbatuar.

Mirëmbajtja e laboratorëve bëhet nga staf i IT mbi bazën e një fondi të veçantë.

Për programin e studimit Institucioni ka vënë në dispozicion edhe ambjentet e bibliotekës. Literatura që ofron është në gjuhën shqipe dhe të huaj (kryesisht greke). Kjo bibliotekë ofron edhe tekste mësimore

universitare. Institucioni ndjek një politikë në lidhje me pasurimin e bibliotekës në përputhje me kërksat që burojnë nga departamentet dhe stafi akademik.

Po punohet që biblioteka të realizojë sigurimin e materialeve edhe në formë elektronike.

Në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve studentore Institucioni vë në dispozicion edhe një ambient ku Këshilli studentor organizon takimet e tij [**vizita në institucion**].

Në aneks paraqiten në mënyrë të detajuar mjediset për programin e studimit dhe mjediset për stafin.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Mjediset për Programin e studimit**

- Salla për leksione – 6 salla
- Klasa për seminare – 6 salla
- Salla për aktivitete promovuese – 1 sallë
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale – 3 salla
- Laboratorë për lëndët – 6
- Laboratorë informatike – 3
- Salla interneti – nuk ka
- Salla për bibliotekë – 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj - 1
- Zyrë informacioni për studentët – 1
- Nyje hidrosanitare - 4

**Mjediset për stafin:**

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin – 2
- Zyra për sekretarinë mësimore – 1
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore – 1
- Zyra për personelin akademik – 2

*GVJ shpreh se të dhënat e paraqitur më sipër, në Tabelën 7 RVB dhe në Aneks të RVB janë verifikuar mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe vizitës të kryer në universitet. Konkludojmë që gjejmë një përputhshmëri dhe shprehim që kjo infrastrukturë është e mjaftueshme për të garantuar zhvillimin e programit të studimit.*

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Nuk ka dokumentacion të marrë në vizitë për këtë rubrikë.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
---------------------	--------------------------

**V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI**

**Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Departamenti Informatikë e Zbatuar përmes stafit që angazhohet për këtë program studimi ofron literaturë në dispozicion të studentëve. Në shqyrtimin e syllabuseve kjo literaturë jepet në formë të detyruar dhe ndihmëse. Literatura plotësohet me kërkimin në internet dhe mundësinë e përdorimit të e-book. Në bibliotekë gjenden botime periodike të revistave dhe bashkëpunon me librarinë elektronike të Universitetit të Pireut <a href="http://digilib.lib.unipi.gr/ke/">http://digilib.lib.unipi.gr/ke/</a>.</p> <p>Një pjesë e saj pasqyrohet edhe në fondin e bibliotekës. Kjo bibliotekë ka një fond të pasur me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj. GVJ zhvilloi edhe një takim me drejtues të Bibliotekës dhe inspektoi raftet ku ekspozohet edhe literatura për këtë program studimi. Në punën e saj biblioteka pasuron literaturën mbi bazën e kërkesave që burojnë nga departamentet. Për vitin akademik 2018-2019 nuk evidentojmë pasurim të saj me literaturë në fushën e informatikës <b>[dok shtese – pasurimi i bibliotekës]. Rekomandojmë që të bëhet pasurimi me literaturë edhe për këtë program studimi.</b></p> <p>Biblioteka punon në orarin e programit të studimeve dhe në përshtatje me oraret sipas nevojave të studentëve (veçanërisht gjatë sezonit të provimeve).</p>
--	--

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që</p>	<p>Kolegji Universitar “LOGOS” ofron një infrastrukturë të duhur për të garantuar zhvillimin e programit të studimit. Godina ku zhvillohet ky program është i vendosur në zonë urbane dhe e ndërtuar sipas KTZ dhe shfrytëzimit. Institucioni është i pajisur me certifikatat për kushtet higjieno – sanitare dhe mbrojtjen nga zjarri <b>[dok. 132: Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri datë 31.10.2018; dok.133: Formulari higjieno-sanitar datë 06.02.2017].</b></p> <p>Për këtë program studimi ofrohen 4 laboratorë të cilat janë të pajisur me të gjithë programet dhe pajisjet e duhura për të mbështetur temat teorike që ofrohen në këtë program studimi. Për mirëmbajtjen e tyre është edhe qendra e IT. I gjithë programi mbështetet nga infrastruktura dhe laboratorët që vetë institucioni zotëron.</p> <p>Ky program studimi nuk ofron zhvillimin e praktikës profesionale.</p>
---	--

zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

**Konkluzione të GVJ:**

GVJ evidenton që Kolegji Universitar "LOGOS" garanton një infrastrukturë të duhur për zhvillimin e programit të studimit "Bachelor" në "Informatikë të zbatuar". Pasuria dhe paprekshmëria e saj i gjejme të shprehura në Nenin 6 në Statutin e Institucionit;

GVJ vlerëson që program mësimor mbulohet nga Departamenti Informatikë e Zbatuar I cili zotëron 4 laboratorë për zhvillimin e tematikës laboratorike. Këto salla shërbejnë edhe për programe të tjera studimi dhe janë në funksion të tyre. Sipërfaqja totale e laboratorëve është 205m<sup>2</sup>.

Institucioni ka edhe bibliotekën e cila zotëron literaturë për të mbështetur programin e studimit. Pasurimi i saj bazohet mbi kërkesat që burojnë nga departamentet. Për vitin akademik 2019 nuk kemi blerje të literaturës në funksion të programit të studimit dhe **GVJ rekomandon një pasurim të saj për vitet e ardhshme akademike.**

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

KU "LOGOS" është institucion jo-fitimprurës dhe funksionon financiarisht dhe juridikisht brenda fondacionit "Logos". Për rrjedhojë, KU "LOGOS" nuk përgatit pasqyra financiare individuale, pasi ato përgatiten në nivel fondacioni [RVB, faqe 39].

Tipari jo-fitimprurës i fondacionit dhe KU "LOGOS" ka mundur tarifa konkurruese të shkollimit në raport me IAL e tjera private në vend, bursa / ndihma të niveleve të ndryshme për studentët, dhe pagesën e tarifave me këste [Aneksi 8/2], [Aneksi 8/3].

Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm [RVB, faqe 39], burimet e të ardhurave të buxhetit për programin e studimit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" janë:

- Të ardhurat nga tarifat e shkollimit të studentëve
- Financimi nga Kryepiskopi i KOASH, si themelues i fondacionit "Logos"
- Financime dhe donacione të tjera nga organizata dhe individë të ndryshëm që nuk bien në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi

Aktualisht, tarifa e studimit për programin "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" është 170,000 lekë në vit [Aneksi 8/1].

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Referuar RVB, të ardhurat dhe financimet e KU "LOGOS" në lekë, për gjashtë vitet e fundit, paraqiten në Tabelën 8 në aneks. Nga kjo tabelë nuk është e qartë se cili është viti i fundit, pasi vitet janë numëruar nga 1 në 6, por referuar Aneksit 10/1, pasqyrat financiare të vëna në dispozicion janë për vitet 2011-2016. Mungojnë pasqyrat financiare për vitet 2017 dhe 2018.

Sic vihet re nga tabela, tre burimet e të ardhurave janë: **tarifat e shkollimit, fondet jopublike, dhe donacionet**. Të ardhurat nga tarifat e shkollimit janë raportuar për student, kurse të ardhurat e tjera janë raportuar në nivel institucioni. Nuk është e qartë nëse të ardhurat nga tarifat e shkollimit kanë qenë në rritje apo rënie, pasi nuk janë marrë parasysh numri i studentëve të programit/institucionit, numri i bursave, dhe ndihmat financiare. Megjithatë, vihet re një tendencë rritje në të ardhurat nga fonde jopublike dhe nga donacionet, të cilat janë faktor kontribues për stabilitetin financiar të institucionit dhe mundësitë për të përballuar programin e studimit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar".

#### Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Referuar RVB, shpenzimet për çdo student për programin e studimit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" rezultojnë të jenë 230,090.33 lekë [RVB, faqe 40]. Në këto shpenzime janë llogaritur vetëm shpenzimet operative (paga, personeli, sigurimet shoqërore, energji, ujë, telefon, shpenzime kancelarie, etj.), kurse investimet kapitale (sipërfaqja e shfrytëzueshme, palestra, pajisjet laboratorike, etj.) nuk janë marrë parasysh, pasi ato mbulohen nga Fondacioni "Logos". Vihet re se kostoja për student është më e lartë se sa tarifa e plotë e studimit, që është 170,000 lekë për student.

#### Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni përkatës është pjesë e anekseve të dosjes së programit [Aneksi 10/1: Pasqyrat financiare të vitit 2011-2016], [Aneksi 10/2: Raport i audituesit të pavarur për pasqyrat financiare të vitit 2016, 2017], [Aneksi 10/3: Vërtetim i NBG mbi garancinë financiare të KU "Logos"]. Pas vizitave në institucion nuk u kërkua dokumentacion shtesë në lidhje me këtë rubrikë.

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>KU "LOGOS" ka kryer auditime të jashtme të përvitshme nga një kompani e pavarur auditimi, "Financial Consulting Studio K&amp;L" [Aneksi 10/2: Raport i audituesit të pavarur për pasqyrat financiare të vitit 2016, 2017]. Raportet e auditimit paraqesin situatën financiare dhe përdorimin e buxhetit në nivel Fondacioni, ku përfshihen programet e ciklit të parë "Bachelor" dhe të dytë "Master Profesional".</p> <p>Raporti i përvitshëm i auditimit përfshin në pasqyrat e tij kontributet dhe detyrimet financiare për programet e studimit "Bachelor" dhe "Master Profesional". Ky raport gjithashtu përmban një pasqyrë të granteve të huaja të përfituara, kontratave dhe shërbimeve në funksion të realizimit të programeve të studimit.</p>
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b> <b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifët e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Fondacioni "Logos", ku bën pjesë KU "LOGOS", harton pasqyra të përvitshme financiare për të vlerësuar gjendjen financiare të tij. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm i janë vënë në dispozicion pasqyrat financiare deri në vitin 2016 [Aneksi 10/1: Pasqyrat financiare të vitit 2011-2016].</p> <p>Edhe pse vihet re një kosto më e lartë për student se sa tarifa e plotë e studimit, kostot shtesë mbulohej nga të ardhurat prej Fondacionit "Logos", të cilat ndihmojnë në qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe programit të studimit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar".</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>GVJ konstaton se KU "LOGOS" funksionon si pjesë e fondacionit jo-fitimprurës "Logos", i cili vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare në mënyrë të përvitshme nëpërmjet auditëve të jashtme dhe pasqyrave financiare.</p> <p>GVJ është i mendimit se, edhe pse programi "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" ka një numër të kufizuar studentësh dhe kostoja financiare për student e tejkalojnë tarifën e plotë të studimit, KU "LOGOS" dhe fondacioni "Logos" në tërësi dëshmojnë një qëndrueshmëri financiare dhe diversitet të burimeve të të ardhurave, duke garantuar mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është në fokus të punës në Kolegjin Universitar “LOGOS”. Kjo shprehet në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2024 [dok 23], Prioriteti Strategjik Nr.6: Sigurimi i Cilësisë. Në objektivat e saj synohet:

**Objektivi 1: Të gjitha standardet e cilësisë duhet të përmbushen përmes proceseve të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit.**

Ky objektivi synohet të plotësohet përmes përputhshmërisë me Kodin e Cilësisë, Standartet Evropiane të Arsimit të Lartë si edhe duke zhvilluar procedurat e vlerësimit si pjesë integrale e aktiviteteve institucionale.

**Objektivi 2: Të krijohet sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë.**

Qëllimi i këtij objekti është krijimi dhe zbatimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, për të identifikuar përgjegjësitë funksionale të organeve dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet.

Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë shprehet në Statutin e Kolegjit Universitar “LOGOS” [dok.19: Statut, Kreu III, neni 43 dhe 44]. Për kryerjen e kësaj detyre Kolegji Universitar “LOGOS” ka ngritur më vete në rang institucioni Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me vendim Senati Akademik Nr. 4, datë 08.09.2014 si edhe në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Për hartimin e politikave të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin institucional është ngritur edhe Komisioni i Përhershëm i Cilësisë, me Vendim Nr. 11, datë 07.11.2011 të Senatit Akademik). Me vendim të Senatit Akademik Nr. 14, datë 25.02.2019 është miratuar dokumenti “Politika për Sigurimin e Cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” [dok.shtesë: Politika e Sigurimit të Cilësisë] dhe me Vendim Nr. 15, datë 25.02.2019 të Senatit Akademik është miratuar edhe Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë [dok. shtesë: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë] të cilat i gjejmë me vend për një mirëfunksionim të njësisë.

Me Vendim të Senatit Akademik Nr. 43, datë 08.02.2018 është miratuar grupi i punës së NJSBC në nivel institucional si edhe grupet e punës për Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në bazë të Vendimit nr. 12/2, datë 16.11.2015 dhe që rifreskohet në vitin 2017 [dok. 47 dhe dok.48: Vendim Senati Akademik për përbërjen e NJSBC në nivel institucional dhe në Fakultete;], dok.49: Vendim Senati Akademik për përbërjen e NJSBC në nivel insitucional për vitin 2018;].

Bazuar në Nenin 43 të Statutit të Institucionit, përbërja e NJSBC është 5 anëtarë ku katër prej tyre janë staf akademik me kohë të plotë dhe nuk mbajnë funksione drejtuese ndërsa anëtari i pestë është i rekomanduar nga Këshilli Studentor i Institucionit. Miratimi i anëtarëve të saj bëhet nga Senati Akademik pas përzgjedhjes së kandidatave nga Rektori.

NJSBC ka autonomi operative dhe akse në të gjithë të dhënat e institucionit. Kjo njësi është në varësi direkte të Rektorit, përgjigjet para tij dhe Senatit Akdemik për përmbushjen e detyrës.

Funksionet dhe detyrat e NJSBC janë të parashikuar në Statutin e Institucionit dhe Rregulloren e Brendshme të Departamentit.

Në përputhje me udhëzimet kombëtare për sigurimin e brendshëm të cilësisë, përgjegjësitë kryesore të NJSBS i gjejmë të lidhura me:

- Hartimin e politikave për vetvlerësim- detyrë e Komisionit të Përhershëm të Cilësisë;
- Përcaktimin e Kriteve të vlerësimit – detyrë e NJSBC dhe Komisioni i Përhershëm i Cilësisë;

- Organizimi i anketimeve të cilat bazuar edhe në Statutin e Institucionit, ndërmerren dy herë në vit në fund të çdo semestri – realizimi i të cilave është detyrë e NJSBC;
- Përpunimi i të dhënave dhe hartimi i raporteve vlerësuese – realizimi i të cilave është detyrë e NJSBC.

NJSBC bashkëpunon me departamentin për analizimin dhe vlerësimin e programit të studimit, literaturën, format dhe metodat didaktike të ndjekura nga stafi akademik në program.

Kontrolli dhe përfundimet janë të bazuara në të dhënat e mbledhura nga anketimet me studentët, vlerësimin e bërë nga departamenti për stafin akademik dhe në fund të vitit harton një raport i shoqëruar me rekomandimet përkatëse.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

##### ○ Sa anketime kanë bërë me studentët

Departamenti në bashkëpunim me NJSBC organizon dy anketime në vit me studentët për të marrë vlerësimin e tyre në lidhje me programin mësimor. Anketimet kryhen në fund të çdo semestri akademik dhe në mënyrë anonime. Rezultatet e tyre përpunohen nga zyra e NJSBC dhe të dhënat i paraqiten Shefit të Departamentit.

##### ○ Sa studentë janë anketuar

Nuk kemi të dhëna të qarta në lidhje me numrin e anketimeve të studentëve për periudhën 2012-2017. Evidenca janë dhënë për vitin akademik 2017-2018 ku 11 studentë kanë marrë pjesë në anketim vetëm për një pedagog [dok.72 – Rezultate të pyetsorëve].

##### ○ Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

Të dhënat [12 studente pjesëmarrës në total në anketim] e mbledhura nga pyetësorët janë përpunuar nga zyra e NJSBC. Rezultatet e tyre nuk kanë reflektuar asnjë të metë. Bazuar në raport procesi mësimor, procesi i provimit, mbajtja e të dhënave në regjister dhe reflektimi i tyre në sekretari kanë qenë konform rregullave. Raporti nuk ka nxjerrë asnjë rekomandim përmirësimi.

Njësisia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për zbatimin e politikave të vlerësimit të brendshëm institucional. Ajo bashkërendon punën e saj me departamentin dhe ndërmerr hapa konkrete në lidhje me vlerësimin e programit të studimit. Bazuar edhe në Statutin e Institucionit, NJSBC realizon anketime të studentëve dy herë në vit (përkatësisht në fund të çdo semestri) të cilat plotësohen në formë anonime. Formularët e studentëve i gjejmë të rifreskuara [dok. Vlerësimi i pyetsorëve nga studentët për vitin akademik 2017-2018; dok. shtesë: formulari i vlerësimit të studentëve për vitin 2019]. Ndonëse në raport dhe në takimin gjatë vizitës në Institucion, u shprehen format e matjes së cilësisë për programet e studimit, nuk kemi të dhëna në lidhje me numrin e studentëve pjesëmarrës në anketime (e shprehur kjo në vite). Të dhënat që disponojmë kanë të bëjnë me vitin akademik 2017-2018 ku numri i studentëve të anketuar është 13 [dok.51: rezultatet e pyetsorit per vitin akademik 2017-2018].

Përpunimi i të dhënave nga NJSBC bëhet mbi bazën e një metodologjie të mirëpërcaktuar [dok.50: Metodologji vlerësimi]. Metodologjia e vlerësimit përmban analizën faktoriale dhe sinteza, metodat krahasuese të induksionit dhe dedukcionit, metodat statistikore. Pyetësorët janë të ndërtuar të përmbajnë pyetje të cilat sigurojnë një vlerësim sasior dhe cilësor. Nuk gjejmë në raportin e NJSBC një interpretim të këtyre të dhënave për të kuptuar dinamikën e progresit për realizimin e çdo objektivi ashtu siç është qëllimi bazë i zbatimit të metodologjisë.



Përpunimi i të dhënave bëhet përmes programeve dhe finalizohen në një raport përfundimtar. Rezultatet e anketimeve paraqiten tek stafi akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit. Stafi akademik vihet në dijeni mbi rezultatet e pyetësorëve nga Përgjegjësi i Departamentit në mënyrë individuale **[dok.59: procesverbal për vënie në dijeni të stafit akademik]**. Të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët përpunohen dhe nga analiza e tyre ka rezultuar se, në përgjithësi, studentët janë shprehur pozitivisht.

Një raport përfundimtar paraqitet përmes Komisionit të Përhershëm të Cilësisë edhe në Senatin Akademik i cili ndërmerr edhe përmirësimet e duhura në bazë të problematikës dhe rekomandimeve përkatëse të paqyruara në raport.

Forma të tjera vlerësimi kanë të bëjnë me matjen e performancës së stafit akademik. Për vitin 2018-2019 gjejmë një ristrukturim të formularëve të vlerësimit **[dok.shtese: formularë të vlerësimit për vitin 2019]** të cilat janë edhe në përputhje me Politiken e Sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloren për Sigurimin e saj.

Ndër format e vlerësimit për vitin akademik 2018-2019 janë:

- Formular i studentit për vlerësimin e mësimdhënies së pedagogut të lëndës (e cila është ë ristrukturuar);
- Formular i studentit për vlerësimin e veprimtarisë së Departamentit;
- Formular për vetvlerësim të personelit administrative (i cili plotësohet në mënyrë individuale);
- Formular për vlerësim përmbljedhës të personelit administrative (i cili plotësohet nga Administratori)
- Formular vëzhgimi nga kolegët (Form 2)
- Formular për diskutim nga kolegët (Form 3)

Sipas përcaktimeve në Statutin e KU “Logos”, Komisioni i përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit dhe NJSBC në nivel institucioni, është ngritur me vendim Senati nr. 11 datë 07.11.2011. Ngritja e grupit të punës së NJSBC, u bë sipas Vendimit të Senatit të KU Logos nr. 4 datë 08.09.2014, me qëllim vlerësimin në mënyrë periodike efikasitetin e procesit mësimor, kërkimor, administrativ, dhe financiar të institucionit. Referuar vendimit të Senatit nr 43 datë 08.02.2018, u miratua grupi i punës i NJSBC në nivel institucional, si dhe grupet e punës për Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara.

#### **Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

Kolegji Universitar “Logos” i kushton një vëmendje të veçantë kontrollit të brendshëm të cilësisë. Komisioni i Përhershëm për garantimin e cilësisë është ngritur me Vendim të Senatit nr. 11, datë 07.11.2001 dhe ngritja e NJSBC është bërë bazuar mbi Vendimin e Senatit të KU “LOGOS” nr. 4, datë 08.09.2014. Objektivi kryesor që në momentin e krijimit të kësaj zyre ka qenë vlerësimi përmes anketimeve të studentëve në mënyrë periodike të cilësisë së programeve mësimore, dhe monitorimin e performancës të stafit akademik dhe ndihmës administrativ. Zyra e NJSBC është në varësi të Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton politikat e hartuar për garantimin e standarteve të cilësisë. Konkludojmë që kjo zyrë është aktive. Ajo bashkërendon punën e saj me NJSBC në secilin fakultet dhe me drejtuesit e departamenteve. Ndonëse në Statut përbërja e saj duhet të jetë me 4 anëtarë staf akademik dhe 1 student nga Vendimet e Senatit Akademik kemi një ndrushim në këtë përbërje. Përzgjedhja e anëtarëve të saj bëhet nga Rektori dhe miratohet me Vendim të Senatit Akademik. Aktualisht NJSBC ka 5 anëtarë staf akademik dhe 1 student të propozuar nga Këshilli Studentor. Zgjedhja e anëtarëve të NJSBC bëhet një herë në vit.

Roli i NJSBC konsiston në:

1. Përthithja e mendimit të studentëve në lidhje me programin e studimit dhe të stafit akademik të anagzhuar;
2. Përmirësimi i silabuseve;

3. Monitorimi i procesit të provimeve përmes rishikimit të tezave, procedurës së provimit;
4. Monitorimit të regjistrit të pedagogut;
5. Siguron implementimin e politikave dhe rekomandimeve të dhëna nga Agjensi të Sigurimit të Cilësisë si ASCAL dhe udhëzimet e dhënë nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë;

Të dhënat e mbledhura transferohen në mënyrë individuale tek stafi akademik dhe drejtuesi i departamentit.

**Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Plotësoni Tabelën 4, Aneksi 4)**

Kolegji Universitar "LOGOS" ka hartuar dokumentin që përcakton Politikën Për Sigurimin e Cilësisë, dhe Rregulloren e saj. Përgjegjës për hartimin e këtyre politikave është Senati Akademik përmes Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. NJSBC është përgjegjëse në implementimin e këtyre politikave dhe monitorimin e tyre. Me vendim të Senatit Akademik janë ngritur edhe NJSBC në nivel departamenti që bashkëpunojnë me Përgjegjësien e Departamentit për menaxhimin e cilësisë në programin e studimit.

**Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe në gjendjen e konstatuar gjatë vizitës, Kolegji Universitar "LOGOS" ka krijuar Njësitë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Për vitin akademik 2018-2019 janë ndërmarrë vetëvlerësime edhe për stafin administrativ dhe vlerësim përmbljedhës nga Administratori. Nuk kemi të dhëna në lidhje me rezultatet e tyre.

**Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

Politikat e sigurimit të cilësisë janë subjekt i përmirësimit të vazhdueshëm. GVJ konstaton se ka përmirësime të formularëve të anketimit me studentët dhe rritje të formave të vlerësimit edhe për stafin akademik dhe administrativ. **Rekomandojmë që të dhënat të pasqyrohen për çdo vit akademik dhe të bëhet një interpretim i tyre në lidhje me progreset e arritura veçanërisht për këtë program studimi.**

**GVJ arrin në përfundimin se Kolegji Universitar "LOGOS" ka politika të qarta të vlerësimit të mbështetura në standartet e cilësisë. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara.**

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

- Formularë anketimi për vitin 2019;
- Politika e Sigurimit të Cilësisë;
- Rregullore e Sigurimit të Cilësisë

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGrameve TË Studimeve</b> <b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>Kolegji Universitar "LOGOS" ka të institucionalizuar sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në zbatimin e politikave ndjek një metodologji vlerësimi e përcaktuar mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga grupe target si studentë, staf akademik, staf administrativ, personel në vendim-marrje.</p> <p>Të dhënat e mbledhura pasqyrohen në një raport të shoqëruar me rekomandimet përkatëse.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit jepen në formë individuale tek stafi akademik, drejtuesi i Departamentit [<b>dok.59 – procesverbal për rezultate të pyetsoreve</b>]. Bazuar në evidencat e paraqitura raporti i NJSBC nuk ka evidentuar asnjë të më të lidhje me procesin mësimor, procesin e provimit, regjistrin e pedagogut në lidhje me frekuentimin e studenteve dhe mënyrën e vlerësimit dhe hedhjes së notave të provimit.</p> <p>Metodat e përdoura janë të përcaktuara në metodologjinë e vlerësimit [<b>dok. Metodologji vlerësimi</b>] dhe ndër format më të konstatuara nga ana jonë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Anketimi me studentët i cili kryhet dy herë në vit në fund të çdo semestri. Anketimet kryhen në formë anonime dhe të dhënat përpunohen në formë statistikore;</li> <li>- Anketim për vlerësimin e veprimtarisë së Departamentit; Kjo formë anketimi është shtuar për vitin 2018-2019 por GVJ-së nuk iu paraqit evidencë në lidhje me rezultatet e kësaj veprimtarie. [<b>dok. shtese-formulare për vitin 2019.</b>]</li> <li>- Anketim për vetvlerësim të personelit administrativ (i cili plotësohet në mënyrë individuale); NJSBC për vitin akademik 2018-2019 NJSBC ka shtuar edhe një formular të ri i cili merr në shqyrtim stafin administrativ dhe bën një vlerësim të tij. Gjithsesi GVJ nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me rezultatet e këtij anketimi [<b>dok. shtese-formulare për vitin 2019.</b>]</li> <li>- Anketim vëzhgimi nga kolegët – peer to peer evaluation (Form 2) [<b>dok. shtese-formulare për vitin 2019.</b>]</li> </ul> <p>Krahas tyre nga ana e Departamentit organizohen edhe dëgjime në auditor, vlerësim të vazhdueshëm gjatë vitit, ndjekje e progresit profesional të stafit akademik.</p> <p>Të dhënat shprehen në raportin vjetor të Departamentit.</p> <p>GVJ vlerëson që NJSBC bazuar mbi një metodologji vlerësimi ndërmerr anketim të studentëve për të matur cilësinë e programit mësimor. NJSBC ka përmirësuar format e saj duke shtuar edhe formularë të rinj për matjen e cilësisë së punës edhe të stafit administrativ dhe vlerësimit të stafit akademik për njëri-tjetrin. GVJ nuk disponon të dhëna statistikore për format e reja të vendosura për vitin akademik 2018-2019 por vlerëson</p>

	përmirësimet në këtë drejtim.
--	-------------------------------

### VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

#### Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Bazuar në dokumentacion ligjor të konstatuar, Urdhërat e MASH, Vendime të KA dhe BA, GVJ arrin në konkluzionin se KU "LOGOS" përmbush kërkesat ligjore për akreditimin institucional përpara akreditimit të programeve të studimit.

Kolegji Universitar "LOGOS" i kushton një vëmendje Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Për këtë ai ka ngritur me vendim të Senatit Akademik Komisionin e Përhershëm të Cilësisë dhe NJSBC. Në lidhje me këtë në vitin 2019 ka hartuar edhe Dokumentin mbi Politikën e Sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloren e saj.

NJSBC bashkërendon punën e saj me NJSBC në nivel fakulteti. Për monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë në programin e studimit ajo koordinon punën me drejtuesin e departamentit. Ajo është pjesë e monitorimit të procedurës së provimeve, regjistrimit të stafit akademik, dhe procesit të përmirësimit të silabuseve në përputhje me standartet e kërkuara.

Bazuar edhe në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2024 dhe në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, GVJ evidenton se ka përpjekje të ndërgjegjësimin të të gjithë hallkave brenda institucionit në lidhje me rëndësinë e garantimit të cilësisë duke e konsideruar atë si një çështje që i përket të gjithëve.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ vlerëson që Kolegji Universitar "LOGOS" ka institucionalizuar Sitemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

GVJ vlerëson që Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm të Cilësisë dhe NJSBC të cilat garantojnë hartimin e politikave dhe implementin e tyre në çdo fakultet dhe program studimi.

GVJ vlerëson që NJSBC zbaton politikën e sigurimit të cilësisë përmes zbatimit të metodologjisë së vlerësimit.

GVJ vlerëson që NJSBC organizon anketime me studentët dhe me stafin akademik për të bërë një vlerësim institucional të cilësisë së programit të studimit dhe performancës akademike.

GVJ vlerëson që NJSBC bashkërendon punën e saj me NJSBC në nivel fakulteti.

GVJ vlerëson që NJSBC është e aftë të prodhojë raporte të shoqëruar me rekomandim të cilat percillen në mënyrë individuale tek stafi akademik.

**GVJ rekomandon që për këtë program studimi të dhënat të ruhen në vite dhe përpunimi statistikor i tyre të shoqërohet me interpretim për të pasqyruar dinamikën dhe progresin e rezultateve të arritura.**

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

Misioni dhe objektivat kryesorë të programit të studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”, janë të reflektuar kryesisht në Rregulloren e Departamentit Informatikë e Zbatuar [Rregullore e Departamentit “Informatike e Zbatuar, 2018, neni 3 dhe 4:

Ky program ka në misionin e tij:

- të formojë përgatitjen e specialistëve të informatikës me gjuhë programimi, teori dhe praktikë rrjetash kompjuterike, sisteme operative, grafike design, hardware dhe t’i bëjë ata të aftë për të punuar si në institucione shtetërore ashtu edhe ato private në përputhje me kërkesat e tregut.

Misioni lidhet:

- me garantimin e cilësisë dhe plotësimin e standardeve akademike, njohjen me risitë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe pasqyrimin në programet e studimit;
- me nxitjen, mbështetjen dhe zhvillimin e aktivitetit shkencor të pedagogëve dhe studentëve, veçanërisht atyre diplomantë;
- me bashkëpunimin me subjektet zbatuese / kërkimore për identifikimin e kërkesës për specialistë në fushën e informatikës dhe përshtatjen e programeve mësimore në funksion të tyre;
- me aftësimin praktik të studentëve dhe veçanërisht studentëve diplomantë.

Referuar Rregullores së Programit, programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” ka si objektiv përgatitjen teoriko-praktike të studentëve më njohuritë bazë të disiplinave informatike të zbatuara që mundësojnë një formim të shëndoshë të studentit nëpërmjet fitimit të shkathtësive teoriko-praktike të tilla që ai të jetë i aftë për të zhvilluar softuerë aplikativë në fusha të ndryshme të lidhura me kërkesat e ekonomisë të tregut ose institucioneve në përputhje me teknologjitë më të avancuara të informacionit të mbështetura në administrimin e rrjetave dhe Webit [Aneksi 3/5: Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” në Informatikë e zbatuar, neni 12, pika 4].

Ky program studimi u licencua me VKM Nr. 1055, datë 29.07.2009 dhe me Urdhër Nr. 396, datë 02.08.2010 Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka miratuar lejen për ushtrimin e veprimtarisë akademike, ndër të tjera dhe për programin e studimit. Programi u akreditua për herë të parë, për 6 vite sipas legjislacionit të kohës në fuqi, me Urdhër të Ministrisë Nr. 282, datë 4.7.2012, bazuar në Vendimin Nr. 338, datë 08.06.2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Kohëzgjatja normale e programit të studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” është 3 vite akademike dhe ai vlerësohet me 180 kredite ECTS. Programi zhvillohet me kohë të plotë gjatë ditëve të javës, nga e hëna – të premte.

Programi është i organizuar në 3 vite akademike dhe 6 semestra, siç detajohet në **Anekset 4/1: “Plani dhe programi i studimit Informatikë e Zbatuar”**. Ai përmban gjithsej 22 lëndë, të cilat ndahen më tej në module. Këtu përfshihen lëndë të të gjitha tipeve të veprimtarisë A-E [Tabelat 11 në aneks].

Sic paraqitet në Tabelën 10 në aneks, lëndët mund të jenë semestrale ose vjetore, kurse modulet janë të gjitha semestrale. Çdo lëndë drejtohet nga një titullar, i cili nuk është domosdoshmërisht pedagogu që zhvillon të gjitha modulet apo orët në auditor të lëndës.

Institucioni ndjek një politikë në lidhje me përditësimin dhe përmirësimin të planit mësimor dhe silabuseve të lëndëve në këtë program studimi [vizita në institucion]. Përmirësimi është i bazuar në:

- Monitorimi i programit përmes formave të kontrollit të personelit akademik organizuar nga departamenti;
- Raporti i NJSBC i formuluar nga anketimet e studentëve;

- Zhvillimi teknologjik dhe kërkesat e tregut të punës (mbi baza individuale të personelit akademik dhe jo bazuar në një studim të tregut të punës nga institucioni ose departamenti);
- Ngritja profesionale e stafit akademik (PAE dhe PAK) përmes pjesëmarrjes në konferenca dhe trajnime;
- Përthithja e mendimit nga studentët aktualë dhe të diplomuar (alumni);

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi**

Viti i fillimit të programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” është viti akademik 2009-2010.

Misioni, qëllimi dhe objektivat e programit të studimit janë të përcaktuara kryesisht në Rregulloren e Departamentit “Informatikë e Zbatuar” [**Aneksi 3/4, neni 3 dhe 4**] dhe shumë pak në Rregulloren e Programit të studimit [**Aneksi 3/5, neni 12, pika 4**]. Gjithashtu misioni, qëllimi dhe objektivat e programit paraqiten të riformuluara me më shumë detaje në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm [**RVB, faqe 8**], megjithëse nuk është e qartë nëse këtu raporti i referohet ndonjërit prej dokumentave bazë të institucionit. GVJ vlerëson se këto qëllime dhe objektiva të programit të studimit janë në përputhje me objektivat e Kolegjit Universitar “LOGOS”.

GVJ rekomandon që qëllimet dhe objektivat e programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” të saktësohen më të detajuara në Rregulloren e Programit, përsa i përket dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale (fushave të punësimit) që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit.

#### **Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)**

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 semestër ka 15 javë mësimore në auditor

#### **Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.**

Të dhënat e planit mësimor sipas viteve akademike, si dhe ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë, paraqiten në Tabelën 10 në aneks. Siç vihet re, kreditet ndahen në mënyrë të barabartë sipas viteve akademike, pra 60 ECTS për çdo vit akademik. Në tabelën 10 ndarja bëhet në bazë të lëndëve, jo të moduleve. Të dhëna më të detajuara të ndarjes në bazë të moduleve u vunë në dispozicion pas vizitës në institucion nëpërmjet Tabelës 13, në aneks.

Tabelat 11.a dhe 11.b në aneks paraqesin ndarjen e lëndëve sipas veprimtarisë formuese (A-F) dhe (A-E) në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, dhe totalin e krediteve për secilën veprimtari. Përqindjet që zënë veprimtaritë formuese, në bazë të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, Shtojca nr. 1, përmbliken në Tabelën 11.c në anekse.

Siç vihet re nga Tabela 11.b, me disa përjashtime të vogla, kjo ndarje është konform normave të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018.

Një mungesë që vihet re në planin mësimor është praktika profesionale, e cila do u mundësonte studentëve të këtij programi të ushtrorin aftësitë e tyre zhvilluese apo administruese në një mjedis pune dhe të zgjidhin probleme reale. Aktualisht, institucioni ka bërë hapat e para drejt arritjes së një marrëveshjeje bashkëpunimi me një kompani zhvillimi softueri [**vizita në institucion**]. Synimi është që institucioni t’u verë në dispozicion dy kate të godinës, ndërkohë që kompania do të ofrojë praktikën profesionale për studentë të

programit dhe një laborator kompjuterik ku ata të ushtrohen. Një draft i kësaj marrëveshje është vënë në dispozicion pas vizitës në institucion [dok: **Marrëveshje me Bizneset – Helius Systems**].

Me përjashtim të faktit që mungon praktika profesionale, GVJ është i mendimit se plani mësimor i programit të studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” është në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit, të paraqitura në Seksionin 1 të këtij raporti.

**Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit [RVB, faqja 60]:**

- |                        |   |
|------------------------|---|
| ▪ Për leksionet        | 10-12 orë në auditor dhe 13-15 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për seminarët        | 10-12 orë në auditor dhe 13-15 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për laboratorët      | 10-12 orë në auditor dhe 13-15 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar | 5 orë në auditor dhe 20 orë punë e pavarur e studentit        |

**Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara**

Të dhënat e ndryshimeve në planin mësimor janë vënë në dispozicion nëpërmjet Tabelës 12. Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se tabela paraqet ndryshimet ndërmjet viteve akademike 2016-2017 dhe 2017-2018. Ndryshimet janë bërë për të pasqyruar zhvillimet e reja në Informatikë.

Në përmbledhje, nuk ka lëndë apo module që janë hequr apo janë shtuar në kurrikul. Ndryshimet konsistojnë në numrin e krediteve ECTS dhe orëve përkatëse për disa prej moduleve. GVJ mendon se këto ndryshime nuk i çënojnë qëllimet dhe objektivat e programit të studimit.

**Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës**

Planet mësimore sipas lëndëve të lidhura me titullarët përkatës paraqiten në Tabelat 13 të RVB, nga viti akademik 2012-2013 deri në 2017-2018 [RVB, faqe 68-83]. Me kërkesë të GVJ, KU “LOGOS” vuri gjithashtu në dispozicion planet mësimore sipas *moduleve* të lidhura me pedagogët përkatës që kanë zhvilluar orët mësimore, nga viti akademik 2016-2017 deri në semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019, të paraqitura në Tabelat 13 në aneks.

**Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.**

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

GVJ ka bërë një kontroll të plotësisë dhe cilësisë së silabuseve të çdo lëndë të programit të studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”, të cilat janë të disponueshme në [dok. **“Plani mësimor, programet e**

**lëndëve me syllabuset për programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”].** Silabuset i korrespondojnë lëndës, por në listën e temave të lëndës detajohet përmbajtja e secilit modul.

Silabuset janë konform planit mësimor në Tabelën 10 dhe titullarëve të listuar në Tabelën 13, megjithatë nuk i specifikojnë pedagogët që zhvillojnë modulet përbërëse. Gjithashtu, në dokumentacion mungon silabusi i lëndës “Diploma”.

Në përfundim të kontrollit të sylabuseve, GVJ mendon se ato janë të plota dhe me të gjithë elementët e listuar më sipër.

**Analizë e cilësisë së sylabuseve**

Sylabuset e lëndëve janë bashkëkohore dhe konform objektivave të programit të studimit. Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse është e përshtatshme për lëndën dhe relativisht bashkëkohore.

Përgatitja e silabusit të çdo lënde kryhet nga titullari përkatës, duke respektuar një format standard (i bazuar në rekomandimet e ASCAL) dhe lirinë akademike. Rishikimi i tyre bëhet në fillim të çdo viti akademik, në bazë të zhvillimeve të reja në fushën përkatëse dhe feedback-ut të aktorëve të ndryshëm (personeli akademik, studentët, etj.). Miratimi i tyre bëhet nga Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit, në përputhje me Rregulloren e Programit [Aneksi 3/4].

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

- Marrëveshje me Bizneset – Helius Systems

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” është i organizuar në lëndë/module dhe vlerësohet në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 ECTS. Për të tre vitet e studimit, studenti duhet të grumbullojë 180 ECTS që të diplomohet.</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për sylabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Departamenti Informatikë e Zbatuar jep informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimit, lëndët e detyruara dhe ato me zgjedhje për çdo semestër.</p> <p>Një nga dokumentat bazë për shpërndarjen e informacionit është silabusi i lëndës, i cili u vihet në dispozicion edhe studentëve në fillim të lëndës. Aty specifikohen informacionet e nevojshme për qëllimet e lëndës, tematikat, ngarkesa mësimore, orët në auditor, orët e laboratorit, frekuentimi, format e vlerësimit, literatura etj [dok. “Plani mësimor, programet e lëndëve me sylabuset për programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”].</p>



**Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ gjykon se plani mësimor i programit të studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” është i përshtatshëm dhe në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit.

GVJ konstaton se në organizimin e planit mësimor mungon praktika profesionale, e cila konsiderohet e dobishme për natyrën e këtij programi. **GVJ rekomandon shtimin e praktikës profesionale në planin mësimor të programit.**

GVJ vlerëson se silabuset e lëndëve janë të plota, bashkëkohore dhe konform objektivave të programit të studimit.

GVJ gjykon se departamenti Informatikë e Zbatuar jep informacionin e nevojshëm për përmbatjen e programit të studimit, lëndët e detyruara dhe ato me zgjedhje për çdo semestër.



## 8.Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

Programi i studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” ofrohet në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, Departamenti Informatikë e Zbatuar. Programi ofrohet për një periudhë tre-vjeçare i vlerësuar me 180 ETCS. Programi ofron një ngarkesë totale në auditor 2055 orë (930 orë leksione, 585 orë seminare dhe 540 orë laboratore). Ky program nuk ofron praktika profesionale ndonëse u kërkua dhe u konsiderua e rëndësishme nga takimi me studentët dhe alumni. Ngarkesa mësimore është 15 javë mësimore për çdo semestër duke respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 80/2018 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit ofrohet në 6 veprimtari:

- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A): A: Në këtë veprimtari organizohen 5 lëndë (36 ECTS) me një peshë 20%;
- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B): Në këtë veprimtari organizohen 9 lëndë (86 ECTS) dhe ka një peshë 47.8%;
- Veprimtari në disiplina të ngjashme dhe/ose karakterizuese (C): Në këtë veprimtari organizohen 2 lëndë (26 ECTS) dhe ka një peshë 14.5%;
- Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D): Në këtë veprimtari organizohet 1 lëndë (6 ECTS) me peshë 3.3%;
- Njohuri të thera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh apo praktika (E): Në këtë veprimtari ofrohet vetëm gjuhë anglisht dhe greqisht në një total 20 ECTS me peshë 11.1 %.
- Teza e diplomës (F) : Tema e diplomës ofrohet me provim dhe vlerësohet me 6 ECTS dhe ka një peshë 3.3%

Bazuar në VKM Nr.41 date 24.01.2018 pesha për secilën veprimtari është si më poshtë (Aneksë: Tabela 11.c):

Tipi i veprimtarisë	Total kredite	% e totalit	Norma % e totalit (sipas VKM Nr. 41, dt. 24.1.2018)
A (LËNDË BAZË)	36	20.0%	15%-20%
B (LËNDË KARAKTERIZUESE)	86	47.8%	50%-55%
C (LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE)	32	17.8%	12%-15%
D (LËNDË PLOTËSUESE)	20	11.1%	10%-15%
E (DETYRIME PËRMBYLLËSE)	6	3.33%	3%-5%

Norma (%) e totalit bazuar edhe në VKM nuk plotësohet në masën 2.2% për kategorinë B dhe në masën 2.8 % tejkalon kufirin për kategorinë C. **Rekomandojmë një rregullim të numrit të krediteve për lëndet në këto dy kategori për të krijuar një program i cili duhet të jetë edhe në përputhje me standardet e përcaktuara përmes VKM Nr.41 date 24.01.2018.**

Lidhur me këtë është, konstatohet se Institucioni tashmë e ka iniciuar procesin e përditësimit të planit mësimor të programit “Informatikë e zbatuar”, brenda masës 20%, ku ndër të tjera synohet edhe korrigjimi i numrit të krediteve dhe përqindjeve sipas normave të VKM. Vendimi është marrë nga Senati Akademik me vendim nr. 18, dt. 25/02/2019 [dok. “Për miratimin e udhëzimit për realizimin e ndryshimit të programit të studimit në masën 20 përqind”].

Përmbajtja e secilës lëndë është e shprehur qartë në silabus [dok shtese - Silabusët]. Në secilin silabus të shqyrtuar është përcaktuar qartë emërtimi i lëndës, ngarkesa, tipologjia e lëndës (detyruese apo me zgjedhje), adresa elektronike e pedagogut të lëndës, përmbledhje dhe rezultate të të nxënit, konceptet themelore,

temaitika e lëndës e cila është e përshkruar qartë, format e kontrollit, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura bazë e detyrueshme dhe e rekomanduar.

Në silabus janë dhënë qartë format e kontrollit të dijeve. Kontrolli i ndërmjetëm vlerësohet me 30 pikë, aktivizimi në seminare dhe teste vlerësohet me 10 pikë dhe provimi përfundimtar vlerësohet me 60 pikë. Në silabus shprehet edhe masa e frekuentimit e cila për leksione është në masën 75%. Kontrolli i vazhdueshëm shprehet me format e saj në silabus dhe gjejmë përputhshmëri me zbatimin e saj [**takimi me studentët, takim me stafin akademik**]. Në silabus për lëndë që trajtojnë seminare dhe orë laboratorike gjejmë tematikën por jo të specifikuar për orët laboratorike dhe seminare. Rekomandojmë që të bëhet pasqyrim i tyre edhe në silabus në mënyrë që të jepet një kuadër i plotë i formimit teorik dhe aftësimi praktik të studentit. Literatura është bazë dhe detyruese. Ndonëse në silabus jepet literatura në libra, shumica e lëndëve mbulohe me skripte. Pasurim i bibliotekës me literaturë ndikon edhe në këtë drejtim.

Programi i studimit është në një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Në vitin akademik 2018-2019 janë bërë ndryshime në masën 20% të bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kryesisht kemi ndryshime në kalimin e lëndës nga një kategori në kategori, ndryshim të orëve laboratorike dhe ndryshim të numrit të krediteve për disa lëndë. Evidentojmë ndjekjen e një procedurë të qartë për ndryshimin në programin e studimit. Ndiqen hapat [**dok 27: Raport mbi ndryshimet në program**]:

1. Identifikimi i nevojës për ndryshim: kjo realizohet nga stafi akademik si pasojë e ndryshimeve në teknologji, kërkesa e tregut të punës dhe zbatimi i literaturës bashkëkohore;
2. Diskutimi i ndryshimeve në departament;
3. Përcjellja e dosjes në Rektorat dhe shqyrtimi i saj nga Komisioni i Kurrikulave;
4. Vendimi për ndryshim nga Senatit Akademik.

Kjo procedurë përmirësimi është e shoqëruar me plan – veprimi (specifikohet në afatin kohor dhe grupet përgjegjës për zbatimin e saj). Në procedurën e përmirësimit të silabuseve një rol luan edhe NJSBC e cila përmes anketimeve me studentët, realizon matjen e performancës akademike të stafit, kontrollit të procedurës së provimeve.

Stafi akademik efektiv për këtë program studimi është me eksperiencë. Numri total është 4 dhe gjejmë një mbingarkesë të tij për këtë program studimi. Kjo u theksua edhe në takimin me stafin akademik dhe drejtuesin e departamentit. Ndonëse janë bërë përpjekje për rekrutim të stafit, kjo e fundit mbetet një problematikë. Stafi ka eksperiencën e duhur. Metodot e mësimdhënies janë korrekte. Metodot i gjejmë të përshkruara qartë në silabus dhe takimi me studentët evidentoi zbatimin praktik të tyre. Vizita në terren verifikoi përdorimin e mjeteve audiovizive për zhvillimin e leksioneve dhe orëve laboratorike.

Në fillim të çdo viti akademik studentëve u bëhet e qartë rregullorja e lëndës, përmbajtja e silabuseve dhe detyrimet përkatëse që ka në lidhje me vlerësimin e njohurive. Këto janë të shprehur qartë në silabus dhe u vërtetuan edhe në takimin e bërë me studentët.

Kontrolli i njohurive bëhet përmes pjesëmarrjes në orë leksioni, seminare, orë laboratorike, detyra kursi dhe përmes provimit të ndërmjetëm që zhvillohet në mes të një semestri akademik dhe provimit final i cili mbulon të gjitha temat që nuk janë prekur në provimin e ndërmjetëm.

Studentëve u ofrohet edhe asistencë në lidhje me progresin e tyre. Asistenca jepet përmes procesit të tutoriatit. Tutoriati kryhet nga stafi akademik i brendshëm por edhe stafi akademik me kohë të pjesshme jep ndihmën e duhur për çdo student që paraqet vështirësi. Gjithashtu numri i pakët i studentëve mundëson edhe një komunikim aktiv pedagog – student [takim me studentet, takim me stafin akademik].

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:**

- Leksione
- Seminare

- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Metodat e mësimdhënies përdoren përfshijnë leksionet, seancat e diskutimeve në seminare, si dhe prezantimin dhe diskutimin e materialeve të marra nga literatuara apo interneti. Materiali bazë për kursin janë leksionet në klasë, të cilat zhvillohen nëpërmjet prezantimit me powerpoint për secilin leksion, të shoqëruara me referencat në literaturën bazë. Gjatë zhvillimit të seminareve theksi vendoset në përsëritjen e koncepteve bazë, konsolidimin e njohurive teorike të marra në leksione dhe mbi të gjitha zhvillimin e aftësisë për zbatimin praktik të tyre nëpërmjet zgjidhjes dhe analizës së problemeve të ndryshme. Në fund të orës së seminarit formulohen konkluzionet përmbljedhëse, si dhe caktohen detyra për t'u zhvilluar jashtë auditorit, të cilat do të kontrollohen dhe vlerësohen në fillim të seminarit pasardhës. Gjatë gjithë kohës së zhvillimit të seminarit, përpjekjet shkojnë në aktivizimin maksimal të të gjithë studentëve të pranishëm dhe në nxijen e iniciativave të tyre. Studentët luajnë një rol aktiv në diskutimet në klasë dhe seancat e zgjidhjes së situatave që paraqesin rastet e marra në studim [**dok shtese: silabuset, takim me studentët, takim me stafin akademik**].

**Format e kontrollit të njohurive**

Format bazë të kontrollit janë edhe pjesëmarrja e studentit dhe provimet. Vlerësimi i studentit për këto komponentë jepet në fillim të vitit, shprehet qartë në silabus dhe në Rregulloren e Departamentit.

- Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrje aktive: 10 pikë
- Provim i pjesëshëm: 30 pikë
- Provim final: 60 pikë

Dhënia e rezultateve të provimit dhe procedura e ankimit është në përputhje me Rregulloren e Departamentit.

**Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj**

Stafi akademik theksoi rolin e pjesëmarrjes aktive të studentëve. Për këtë aktivizimi i tyre vlerësohet edhe me 10 pikë. Studentët aktivizohen dhe inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete shkencore dhe konferenca studentore. Bazuar në evidencat e paraqitura për kërkimin shkencor GVJ identifikoi 3 studentë të aktivizuar për projekte shkencore në rang departamenti dhe 1 student për projekt në nivel Fakulteti. Studentët përmes anktimeve janë pjesë e procedurës së vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe në formularin e ri 2018-2019 ata janë pjesë e vlerësimit të aktivitetit të departamentit.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

- Propozim të programit për ndryshim të tij
- Raport mbi ndryshimet në program
- Silabuset

GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacionin e paraqitur. Bazuar në vizitën në institucion dhe takimet e zhvilluar me drejtues të departamentit, stafit akademik dhe studentët gjen një përputhje midis procedurës dhe zbatimit të saj.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

Departamenti Informatikë e Zbatuar i kushton një vëmendje të veçantë perthithjes së studentëve më të mirë. Për këtë ky Department në bashkëpunim edhe me Zyrën e Karrierës & Alumni organizon takime në Tiranë dhe në rrethe me shkollat e mesme për të bërë edhe sensibilizim të programit. Nga takimi me studentët disa prej tyre kishin vizituar edhe institucionit përpara zgjedhjes së tyre në këtë program studimi. Kolegji Universitar “LOGOS” nuk ofron konvikt për studentët. Fushata sensibilizuese bëhet edhe përmes fletëplalosjeve, broshurave, konferencave studentore, aktiviteteve të Këshillit Studentor etj. Kolegji Universitar “LOGOS” ofron edhe bursa studimi për studentët më të mirë. GVJ evidentoi se ndiqet një politikë e qartë e specifikuar edhe në Strategjinë e Zhvillimit për rritje të numrit të studentëve. Megjithatë konstatojmë se ky numër është relativisht i vogël [të dhënat jepen edhe në aneks]. Nga takimi me drejtesin e departamentit u pranua që ky numër synohet të rritet edhe me hapjen e programit të ciklit të dytë “Master i shkencave” i cili do të sigurojë një vazhdimësi të studimeve më të thelluara të studentëve në këtë drejtim. Kriteret e pranimit janë të specifikuar qartë. Studentët që regjistrohen për herë të parë në këtë program studimi duhet të përmbushin edhe kriteret specifike të vendosura nga departamenti.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

#### **Procedurat e pranimit të studentëve**

Referuar [RVB, faqe 90] dhe Rregullores së Departamentit Informatikë e Zbatuar, neni 14, kriteret e pranimit të studentëve janë si më poshtë:

- Të zotërojë një diplomë të Maturës Shtetërore, apo diplomë të huaj ekuivalente
- Të plotësojë kriterin e mesatares së Maturës Shtetërore të vendosur sipas akteve nënligjore në fuqi
- T’i jetë nënshtruar procedurës së aplikimit në sistemin online
- Të plotësojë kriteret e përcaktuara nga vetë KU “LOGOS”

Për këtë program studimi si kriter shtesë është nota mesatare arithmetike mbi 6 për grup lëndët: Matematikë, Fizikë, TIK, ose Informatikë [Rregullore e Departamentit Informatike e Zbatuar 2018, neni 14].

[RVB, faqe 90] specifikon dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesë kandidati që pranohet në programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”. Meqënëse RVB nuk citon ndonjë vendim apo dokument, GVJ i referohet rregullores së përgjithshme të institucionit [Aneksi 3/2, neni 80: “Regjistrimi”], për listën e dokumentave për regjistrim, si më poshtë:

- Formulari i aplikimit (origjinal, i plotësuar pa korrigjime dhe i nënshkruar).
- Dokument identifikimi (pasaportë ose kartë identiteti).
- Diplomë e maturës shtetërore (origjinale).
- Listë e notave (origjinale).
- (2) dy fotografi dokumentesh.
- Mandati i pagesës së regjistrimit (origjinal).
- Deklaratën për të dhënat personale (sipas udhëzimeve të MASR)

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, bëhet listimi dhe përzgjedhja nga Departamenti Informatikë e Zbatuar, deri në plotësimin e kuotave të miratuara. Studenti i regjistruar ka detyrimin të paguajë tarifën vjetore të shkollimit, përcaktuar në Aneksin 8/1 për sa i përket tarifës së plotë dhe Aneksin 8/2 për sa u përket kriterëve të përfitimit të bursave [RVB, faqe 90].

GVJ gjatë vizitë në institucion, verifikoi dy dosje studentësh të përzgjedhur në mënyrë rastësore: 1 student i regjistruar për herë të parë, dhe 1 student i transferuar. Këto dosje ishin të plota dhe konform listës më sipër. Për studentin e transferuar, dosja përmbante gjithashtu:

- Formulari i transferimit
- Vërtetim notash nga IAL e mëparshme për lëndët e ndjekura

- Vërtetim çregjistrimi nga IAL e mëparshme
- Kurrikula dhe silabuset e programit nga IAL e mëparshme
- Dokument i ekuivalentimit të krediteve të transferuara

Si konkluzion, kriteret e përshkruara më sipër dhe dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

Cilësia në hyrje, numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë, dhe numri i studentëve të transferuar për programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”, paraqiten në Tabelën 17.1 për çdo vit akademik.

Gjatë verifikimit të regjistrimit të sekretarisë mësimore, u konstatuan mospërputhje të vogla me Tabelën 17.2 për numrin e studentëve. Referuar regjistrimit, numrat e saktë janë si në Tabelën 17.2 në anekse.

Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, u konstatua se regjistri i sekretarisë mësimore nuk ishte i plotësuar me studentët e regjistruar në vitin akademik 2018-2019 për shkak të mungesës së pajisjes nga QSHA. Sipas sekretarisë mësimore, totali i studentëve të regjistruar **në vit të parë në vitin akademik 2018-2019** në këtë program studimi, është **14 studentë**.

**Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Nuk ka patur mobilitet të studentëve të programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” brenda Sistemit të Arsimit të Lartë në vend.

**Të dhëna për punësimin e studentëve**

Institucioni nuk ka vënë në dispozicion të dhëna për punësimin e studentëve të programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”.

Gjatë takimit të GVJ me drejtuesin e departamentit dhe dekanen, u tha se të diplomuarit e programit kanë arritur të punësohen të gjithë, por pa u mbështetur në ndonjë statistikë apo studim konkret.

Pas vizitës në institucion, zyra e karrierës vuri në dispozicion një dokument shtesë [**dok: Analiza e punësimit të studentëve KU Logos**], i cili përmban një analizë të punësimit të studentëve të disa programeve, por aty nuk përfshihet programi “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”.

**Numri total të diplomuarve**

Referuar RVB, numri total i të diplomuarve të programit për të gjitha vitet akademike është **149 [Tabela 18 në aneks]**.

**Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)**

Nuk ka të dhëna.

**Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)**

Nuk ka të dhëna.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Pranimit në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve të rinj në programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar” nuk janë të mire-dokumentuara në vendime, por referuar kritereve që listohen në RVB, ato janë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 80/2015, dhe aktet nënligjore në fuqi. Përveç kritereve të parashikuara në ligj, institucioni ka gjithashtu kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”.</p> <p>Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim është i përcaktuar në rregulloren e institucionit [Aneksi 3/2, neni 80: “Regjistrimi”]. Gjithashtu, në RVB përshkruhen procedurat e pranimit në program [RVB, faqe 90]. Procedurat e ndjekura për regjistrim, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, janë konform me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore në fuqi.</p>
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Departamenti Informatikë e Zbatuar u jep studentëve informacionin e detajuar për përmbajtjen e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. Këtu vlen të përmendet roli i pedagogut këshillues që i caktohet një grupi mësimesor studentësh në fillim të çdo viti akademik për t’i mbajtur ata të informuar. Pedagogu këshillues shërben si pikë kontakti për problemet e ndryshme të studentëve, në takime në grup ose individuale.</p> <p>Gjithashtu, studentëve u vihet në dispozicion në fillim të çdo lënde silabusi përkatës, i cili përmban informacionin e nevojshëm në lidhje me lëndën.</p> <p>Në përfundim të çdo semestri, studentët vlerësojnë pedagogët e çdo lënde me anë të pyetësorëve [Aneksi 7/5: <b>Info NjsBC për rezultatet e pyetësoreve</b>]. Pyetësori përmban gjithsej 11 pyetje të shkallës “Likert” me nga 5 alternativa. Nuk ka pyetje të hapura. Pyetësorët e plotësuar i kalojnë NjsBC për përpunimin statistikor.</p> <p>Në KU “LOGOS” funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës [Aneksi 9/1: <b>Vendim Senati për krijimin e Zyres së Këshillimit të Karrierës, dt. 8/9/2014</b>], [Aneksi 9/3: <b>Rregullore e Zyres së Këshillimit të Karrierës 2014</b>]. Gjatë takimit të GVJ me drejtuesen e zyrës u dhanë disa informacione kontradiktore me dosjen e vlerësimit të brendshëm. Sipas drejtueses së zyrës, aktualisht ajo quhet “Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës” dhe funksionon që prej emërimit të drejtueses së zyrës në këtë funksion, në datë 12/12/2018. Sipas saj, kjo zyrë nuk ka ekzistuar më parë, pasi me çështjet e karrierës janë marrë kryesisht pedagogët.</p> <p>Aktualisht, zyra ka në funksionin e saj çështje të këshillimit të karrierës, aktivitete ekstrakurrikulare, trajnime, organizimi i panairit të karrierës, vizitat në gjimnaze dhe organizimi i ditëve të hapura për maturantët. Gjithashtu, kjo zyrë angazhohet në çështje</p>

	<p>të marketingut, në bashkëpunim me një kompani të kontraktuar nga KU "LOGOS". Pas vizitës në institucion GVJ-së iu vu në dispozicion nga kjo zyrë kalendari i aktiviteteve që janë zhvilluar në të kaluarën [dok: <b>Aktivite Zyra e Karrierës</b>] dhe të aktiviteteve të planifikuara për vitin akademik 2018-2019 [dok: <b>Kalendari i aktiviteteve - zyra e keshillimit te karrieres 2018-2019</b>]. Një pjesë e këtyre aktiviteteve, ku vlen të përmendet panairi i karrierës, pritet të zhvillohen për herë të parë nga institucioni.</p>
<p><b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;  <b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Nëpërmjet Sekretarisë Mësimore, KU "Logos" i disponon statistikat vjetore për numrin e të diplomuarve në programin "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" [Aneksi 8/8: <b>Regjistri i Diplomave</b>].  Gjithashtu, Sekretaria Mësimore disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, të tërhequr nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve [Aneksi 8.4: <b>Statistika mbi numrin e studentëve në vite</b>], [Aneksi 8.5: <b>Regjistri i notave të studentëve</b>], [Aneksi 8.6: <b>Regjistri i të dhënave të studentëve (hard-copy, i kontrolluar gjatë vizitës)</b>]. [dok: <b>Studentë të larguar nga programi, një rast largimi</b>].  Institucion disponon edhe të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim [Aneksi 8.5: <b>Regjistri i notave të studentëve</b>].</p>
<p><b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Për këshillimin e karrierës në KU "LOGOS" funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës. Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të këshillimit të karrierës kanë qenë të pakta dhe janë kryesisht plane për vitin 2019 [dok: <b>Kalendari i aktiviteteve - zyra e këshillimit të karrierës 2018-2019</b>]. Një rol në këshillimin e karrierës ka luajtur edhe personeli akademik, vecanërisht drejtuesi i departamentit, i cili ka një përvojë të gjatë në akademi dhe një rrjet të gjerë kontaktesh me tregun e punës.  Për sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me procesin mësimor, një rol të rëndësishëm ka luajtur pedagogu këshillues që caktohet për çdo grup mësimor studentësh.  Në planin e programit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" nuk është parashikuar praktikë profesionale, pra nuk ka patur këshillim për përzgjedhjen e institucionit ku zhvillohet kjo praktikë.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>  GVJ vlerëson se pranimi në programin e studimeve "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në fuqi.  GVJ konstaton se përveç kritereve të parashikuara në ligj, institucioni ka kritere shtesë (mesatarja e lëndëve Matematikë, Fizikë, dhe TIK nga shkolla e mesme) për përzgjedhjen e kandidatëve për programin e studimit</p>	



“Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”.

GVJ konstaton se sekretaria mësimore e KU “LOGOS” mban të dhëna të detajuara dhe statistika për studentët e këtij programi studimi. Dokumentacioni në dosjet e studentëve është i plotë dhe konform ligjeve.

GVJ gjykon se KU “LOGOS” i informon dhe këshillon mjaftueshëm studentët rreth organizimit të programit të studimit. Këtu luan një rol të rëndësishëm pedagogu këshillues që i caktohet secilit grupi mësimor studentësh.

GVJ konstatoi se KU “LOGOS” ka ngritur Zyrën e Këshillimit të Karrierës për çështje të punësimit të studentëve, por konstatohet se aktivitetet e kësaj zyre kanë qënë të pakta në të shkuarën dhe mbeten kryesisht në formën e planeve dhe kalendareve të aktiviteteve të ardhshme. Në këto plane përfshihet organizimi për herë të parë i “ditëve të karrierës”.

Institucioni nuk i ka vënë në dispozicion GVJ-së të dhëna apo statistika rreth punësimit të studentëve të këtij programi studimi. GVJ rekomandon që zyra përkatëse të kryejë një analizë të punësimit të studentëve të programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”.



## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

Kolegji Universitar "LOGOS" i kushton një vëmendje të veçantë kërkimit shkencor. Kjo shprehet në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2014 ku prioriteti 3-të i saj është kërkimi.

Ndër objektivat kryesore të saj janë:

- Përgatitja e strategjisë së kërkimit.
- Krijimi i profileve të hulumtimit të institucionit.
- Identifikimi i projekteve kërkimore që kanë ndikim në zhvillimin e shoqërisë.
- Përgatitja e paketës së projekteve kërkimore.
- Përdorimi i të gjitha mundësive të financimit për të mbështetur kërkimet.
- Lidhja e hulumtimit me mësimdhënien.
- Krijimi i zyrës së projekteve.
- Krijimi i një bazë të dhënash për hulumtim.
- Përkaktimi i ngarkesës kërkimore për personelin akademik dhe kërkimor.
- Vlerësimi i produktit kërkimor bazuar në metodologjinë matëse kombëtare.
- Përgatitja e portofolit të kërkimit të institucionit.
- Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore.
- Krijimi i rrjetit të studiuesve të rinj.
- Kryerja e hulumtimeve të nivelit të lartë duke sjellë risi për të mundësuar njohjen e universitetit.
- Zhvillimi i marrëdhënieve të reja kërkimore shkencore me bizneset dhe institucionet e tjera akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kolegji Universitar "LOGOS" ka ngritur në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara edhe Qendrën e Kërkimit Shkencor (Qëndër e Kërkimit dhe Zhvillimit – FSHA). Kjo qëndër funksionon mbi bazën e një Rregullore të përcaktuar qartë [**dok. Shtese gjatë vizitës: Rregullore e QKK**]. Kërkimi shkencor në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara është i fokusuar në disa drejtime:

1. Pjesëmarrje në projekte kërkimore shkencore. Në këtë drejtim gjatë pesë viteve të fundit nuk kemi projekte kërkimore të fituara dhe të zbatuara. **Rekomandojmë që Qendra Kërkimore Shkencore në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve më Jashtë të aftësohen në drejtim të aplikimit për projekte.**
2. Bazuar edhe në raportet mësimore dhe kërkimore të dhëna nga departamenti për periudhën 2015 – 2018 evidentojmë që puna kërkimore është e bazuar në nivel individual të stafi akademik në botime kombëtare dhe ndërkombëtare [**dok.59, dok.60, dok.61 dhe 62 : Raporte mësimore dhe kërkimore për vitet 2015-2017**];
3. Pjesëmarrje të stafit në konferenca që IAL KU "LOGOS" organizon në bashkëpunim me partnerë dhe në konferenca ndërkombëtare;
4. Përgatitje për botime monografi dhe tekste;

Kërkimi shkencor i stafit akademik ndiqet nga NJSBC në bashkëpunim me departamentin. Për këtë shpërndahet edhe formulari i kërkimit shkencor dhe të dhënat pasqyrohen edhe në raportin vjetor mësimor dhe kërkimor të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara.

Ekspierienca e fituar e stafit akademik shprehet edhe në punën për përmirësimin e silabuseve.

Kolegji Universitar "LOGOS" ka edhe revistën e saj shkencore e cila mundëson stafin akademik të paraqesë punime të tyre.

Kolegji Universitar "LOGOS" ndjek edhe një politikë mbështetje të kërkimit shkencor përmes inkurajimit të stafit akademik të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare. Ndonëse nga Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë na u paraqit një dokument në lidhje me plan buxhetin për kërkimin shkencor [**dok shitesë: Plan buxheti për kërkimin shkencor**] nuk mund të konkludojmë për përfitimin që ka Fakulteti i Shkencave të Aplikuara apo Zyra e Kërkimit Shkencor në këtë drejtim (të dhënat e buxhetit jepen në total). Gjithashtu nga takimi me përfaqësues të Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe bazuar në dokumentacion për vitet e fundit nuk ka mbështetje financiare të stafit akademik për pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare.

Rekomandojmë një alokim më të mirë të fondeve në lidhje me kërkimin shkencor në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara. **Ndonëse në rang fakulteti është e ngritur Qendra Kërkimore Shkencore nuk gjejmë evidenca të qarta në lidhje me mënyrën e koordinimit dhe bashkëveprimit të saj me departamentet në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në funksion të rritje së kërkimit shkencor.**

Evidentojmë përpjekje të angazhimit të studentëve në aktivitete shkencore përmes pjesëmarrjen në konferenca studentore qe Institucioni organizon. Prioritetet e kërkimit shkencor reflektohen edhe në tema diplomë të zhvilluar nga studentët.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

##### **Të dhëna për kërkimin shkencor**

Të dhënat për kërkimin shkencor reflektohen në Tabelën 19. Në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit dhe takime të zhvilluara me stafin akademik dhe përfaqësues të Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë evidentojmë:

1. Kërkim shkencor në nivel individual të stafit akademik (49 botime).
2. Pjesëmarrje të stafit akademik në konferenca brenda IAL.
3. Përfshirje të studentëve në konferenca studentore.

##### **Rekomandojmë rritje të pjesëmarrjes së stafit në konferenca ndërkombëtare.**

##### **Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

- Veprimtari kërkimore shkencore 2015-2016, 2016-2017,2017-2018;
- Përbërja e Qendrës Kërkimore Shkencore për vitet 2014-2015, 2015-2016, 2016-2019;
- Relacion i Kërkimit Shkencor për vitet 2015-2016, 2016-2017, 2017-2018;
- Relacionin i punës kërkimore shkencore 2011-2015;
- Plan Buxheti për veprimtarinë kërkimore shkencore 2018-2019;
- Formular i Raportimit të Stafit Akademik për veprimtarinë kërkimore shkencore;
- Programi Erasmus +, Marrëveshje, thirrje, aktivitete;
- Projekte Ndërkombëtare;

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

Referuar RVB, KU "LOGOS" ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me universitete brenda dhe jashtë vendit, në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të fushës së kërkimit shkencor [RVB, faqe 97]. Aktualisht KU "LOGOS" ka marrëveshje bashkëpunimi me këto universitete:

- Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"
- Universiteti i Pireut, Greqi
- Universiteti Sancti Cyrilli A.D. 1669, Maltë
- Universiteti i Maqedonisë Perëndimore, Greqi
- Universiteti Oradea, Rumani

Institucioni ka lidhur gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi me komunitetin e biznesit. Aktualisht KU "LOGOS" ka marrëveshje bashkëpunimi me këto biznese dhe institucione [Aneksi 9/11: Marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet]:

- Studio kontabiliteti "Shembitraku"
- Banka Kombëtare Greke (NBG)
- Intersig Vienna Insurance Group
- Telecom Albania
- Shoqata Shqiptare e Turizmit
- Neranxi
- Alumil Albania

Vlen të përmendet edhe draft marrëveshja me Heliuss Systems, e cila nëse realizohet do u shërbejë studentëve të programit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" në ofrimin e praktikës profesionale dhe ofrimin e kompjuterave të rinj [dok: Marrëveshje me Bizneset – Heliuss Systems].

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Referuar Tabelës 20 në aneks, KU "LOGOS" ka vendosur disa marrëdhënie bashkëpunimi me disa universitete brenda dhe jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, institucioni ka bashkëpunime modeste me disa biznese [Aneksi 9/11: Marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet].

#### Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

GVJ konstaton se KU "LOGOS" ka disa bashkëpunime me institucione, organizata profesionale, biznese dhe aktorë të tregut të punës, sic u listuan në pjesën përshkrimore më lart. Këtu përmendet edhe draft marrëveshja me Heliuss Systems, e cila nëse realizohet do u shërbejë studentëve të programit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" në ofrimin e praktikës profesionale dhe ofrimin e kompjuterave të rinj.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
---------------------	-------------------------

<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Personeli akademik dhe administrativ në KU "LOGOS" bashkëpunon nëpërmjet formave të ndryshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkëmbim informacioni nëpërmjet dokumenteve zyrtare, komunikimeve elektronike, mbledhjeve të niveleve të ndryshme, si mbledhje departamenti, fakulteti, senati/rektorati, etj.</li> <li>• Koordinim me zyrat administrative të IAL (sekretarisë mësimore, karrierës, burimeve njerëzore, etj)</li> <li>• Koordinim ndërmjet njësive akademike (departamenteve dhe fakulteteve), ku përfshihet edhe mësimdhënia në departamente të tjera ose nga departamente të tjera</li> <li>• Vlerësimi i performancës së pedagogëve, nga drejtuesit e njësive, dhe nga NJSBC</li> </ul> <p>Për sa më sipër, GVJ gjykon se KU "LOGOS" nxit në mënyrë të mjaftueshme bashkëpunimin midis personelit të tij akademik dhe administrativ për çështjet që lidhen me programin e studimit.</p> <p>Gjithashtu, GVJ është i mendimit se institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi nëpërmjet ndarjes së detyrave të personelit. Këto detyra përcaktohen qartë në disa prej dokumentave bazë të institucionit, sic janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Statuti i KU "LOGOS"</li> <li>• Rregullorja e programit të studimit "Bachelor" në "Informatikë e Zbatuar"</li> <li>• Rregullorja e Departamentit Informatikë e Zbatuar</li> <li>• Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS"</li> </ul>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>KU "LOGOS" ka vendosur disa marrëdhënie bashkëpunimi me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, institucioni ka bashkëpunime modeste me aktorë të biznesit [Aneksi 9/11: Marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet]. Në funksion të këtyre marrëdhënieve të bashkëpunimit, KU "LOGOS" ka ngritur zyrën e marrëdhënieve me jashtë.</p> <p>Programi i studimit "Bachelor" në "Informatikë e zbatuar" nuk përmban praktikë profesionale. Institucioni aktualisht po konsideron vendosjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi me një kompani të zhvillimit të softuerit për të mundësuar praktikën profesionale në të ardhmen.</p> <p>Institucioni ende nuk ka organizuar trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p>GVJ gjykon se KU "LOGOS" nxit bashkëpunimin mes personelit të vet akademik dhe administrativ, edhe përtej departamentit apo fakultetit, në funksion të programit "Bachelor" në "Informatikë e Zbatuar".</p> <p>GVJ konstaton se KU "LOGOS" ka vendosur disa marrëdhënie bashkëpunimi me universitete të tjera brenda</p>	

dhe jashtë vendit.

GVJ është i mendimit se marrëdhëniet e bashkëpunimit me aktorët e biznesit, në funksion të këtij programi studimi janë modeste. **GVJ rekomandon që të shtohen përpjekjet për rritjen e bashkëpunimit, veçanërisht me kompani që veprojnë në sektorin e TIK, për t'i ndihmuar punësimin të studentëve, aftësimin profesional, dhe njohjes më të mirë të tregut të punës.**



## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Për rekomandimin a), **Rekomandimi është përbushur plotësisht.**

Për rekomandimin b), **Rekomandimi është përbushur vetëm pjesërisht nga ana e Institucionit.**

Për rekomandimin c), **Rekomandimi është përbushur vetëm pjesërisht nga ana e Institucionit.**

### **II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

#### **a. Pika të forta:**

- 1) Kërkesat e tregut të punës janë të larta për këtë profil studimi;
- 2) Kolegji Universitar "LOGOS" ka një qëndrueshmëri financiare e cila garanton vazhdimësinë e këtij program studimi;
- 3) Institucioni garanton cilësinë e programit të studimit. NJSBC është subjekt i përmirësimit të vazhdueshëm i formave të matjes dhe monitorimit të cilësisë së programit të studimit;

#### **b. Pika të dobëta:**

- 1) Programi i studimit nuk ka një studim tregu i cili do të garantojë zhvillimin dhe përmirësimin e tij;
- 2) Numri i stafit akademik efektiv (PAE) është i vogël;
- 3) Ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv (PAE) është i lartë;
- 4) Rol i dobët i Qendrës Kërkimore Shkencore në mbështetje të aktiviteteve shkencore të Departamentit Informatikë e Zbatuar;
- 5) Qendra e Karrierës & Alumni nuk ka një analizë të punësimit të studentëve për këtë program studimi;

#### **c. Mundësitë:**

- 1) Kolegji Universitar "LOGOS" ndjek një politikë e cila mbështet kualifikimin profesional të stafit akademik dhe të studentëve;
- 2) Institucioni ofron një infrastrukturë të duhur për zhvillimin e programit të studimit;
- 3) Kolegji Universitar "LOGOS" ka një bibliotekë pasurimi i të cilës duhet të bëhet edhe për vitet e ardhshme për këtë program studimi;
- 4) Stafi akademik me kohë të pjesshme (PAK) zotëron eksperiencën dhe kualifikimet e duhura;

#### **d. Pengesat:**


- 1) Konkurrenca me institucione të tjera të Arsimit të Lartë me profil të njëjtë studimi;
- 2) Niveli modest i marrëveshjeve të bashkëpunimit;
- 3) Mungesa e vazhdimësisë së programit në nivel “Master i shkencave” sjell edhe pengesë në përthithjen e studentëve të rinj dhe në rekrutimin e stafit akademik

**Rekomandimet:**

1. Institucioni apo departamenti nuk ka kryer një studim të mirëfilltë të tregut të punës. Rekomandojmë të ndërmerret një studim tregu për këtë profil studimi.
2. Vlerësojmë që ky Departament nuk përmbush kriterin për një staf akademik efektiv me grada shkencore dhe me numër të konsiderueshëm për të përmbushur standardin për mësimdhënie. Rekomandojmë që Institucioni duhet të zhvillojë një politikë më intensive në lidhje me shtimin e stafit akademik efektiv dhe përthithjen e një stafi me grada të dhura shkencore.
3. Në rang fakulteti është e ngritur si njësi e tretë bazë edhe Qendra e Kërkimit Shkencor për të cilën nuk gjejmë evidenca të plotë të mbështetjes që ajo jep për këtë program studimi. Rekomandojmë një koordinim të punës së saj në mbështetje të Departamentit të Informatikës së Zbatuar.
4. GVJ vë re se një pjesë e personelit akademik me kohë të plotë është i mbingarkuar në mësimdhënie, ku ngarkesa vjetore arrin deri në 330 orë në auditor dhe 7 module të ndryshme semestrale. GVJ rekomandon uljen e kësaj ngarkese në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe outputit shkencor të personelit akademik me kohë të plotë.
5. Për vitin akademik 2019 nuk ka blerje të literaturës në funksion të programit të studimit dhe rekomandojmë një pasurim të saj për vitet e ardhshme akademike.
6. Institucioni nuk i ka vënë në dispozicion GVJ-së të dhëna apo statistika rreth punësimit të studentëve të këtij programi studimi. GVJ rekomandon që Zyra e Karrieres & Alumni të kryejë një analizë të punësimit të studentëve të programit “Bachelor” në “Informatikë e zbatuar”.
7. GVJ rekomandon që të shtohen përpjekjet për rritjen e bashkëpunimit, veçanërisht me kompani që veprojnë në sektorin e TIK, për t’i ndihmuar punësimit të studentëve, dhe njohjes më të mirë të tregut të punës.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Dr. Alketa Grepcka



Dr. Ervin Ramollari





## SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM

### I. SUMMARY ANALYSIS OF FULFILLMENT OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION

1. For recommendation a), The recommendation is fully met.
2. For recommendation b), The recommendation was only partly met by the institution.
3. For recommendation c), The recommendation was only partly met by the institution.

### II. SUMMARY ANALYSIS OF THE RVJ BY SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES OPPORTUNITIES, THREATS).

#### a. Strengths:

1. There is a high demand from the labor market for this study profile;
2. The University College "LOGOS" has a financial stability, which warrants the continuity of this study program;
3. The institution assures the quality of this study program. The Internal Quality Assurance Unit (NjSBC) is subject to the continuous improvement of the forms of measurement and quality monitoring of the study program;

#### b. Weaknesses:

1. This study program does not have a labor market study, which would warrant its development and improvement;
2. The number of full-time academic staff (PAE) is too low;
3. The teaching load of the full-time academic staff (PAE) is too high;
4. Weak role of the Scientific Research Center in support of the scientific activities of the Department of Applied Informatics;
5. The Career & Alumni Office does not have an analysis of the employment of the students of this study program;

#### c. Opportunities:

1. The University College "LOGOS" pursues a policy that supports professional qualification of its academic staff and students;
2. The Institution offers the proper infrastructure for the offering of this study program;
3. The University College "LOGOS" has a library, which should be enriched in the future years as well for this study program;
4. The part-time academic staff (PAK) has the proper experience and qualifications;



d. **Threats:**


1. Competition with other HEIs offering the same study profile;
2. The modest level of the agreements of collaboration;
3. The lack of continuity of this program to the postgraduate level "Master of Science" presents an obstacle in attracting new students and recruit of academic staff

**Recommendations:**

1. The institution or department has not conducted a proper study of the labor market. We recommend undertaking a market study for this academic profile.
  2. According to our evaluation this department does not meet the criteria for an effective academic staff in terms of staff numbers and scientific degrees necessary to meet the teaching standards. We recommend for the Institution to undertake a more intensive policy with the purpose of increasing the effective academic staff and recruiting staff with the appropriate scientific degrees.
  3. There is lack of evidence regarding the support that the Scientific Research Center in the Department of Applied Informatics provides for this academic program. We recommend a coordination of its work in support of the Department of Applied Informatics.
  4. The EEG has discerned that a fraction of the full-time academic staff is overburdened with classes, with an annual workload of up to 330 teaching hours and 7 different semester modules. The EEG recommends lowering the teaching load in view of increasing the quality of teaching as well as the scientific output of the full- time academic staff.
  5. For the academic year 2019, there is no evidence of literature purchases in function of the academic program. We recommend its enrichment for the upcoming academic years.
  6. The institution has not provided the EEG with data or statistics on employment of students of this academic program. The EEG recommends the undertaking of a statistical and data analysis by the Career & Alumni Office regarding the employment of students from the "Bachelor" program in "Applied Informatics".
- EEG recommends that efforts be made to increase cooperation, particularly with companies operating in the ICT sector in order to assist with student employment as well as to obtain better knowledge of the current labor market.

**External Evaluation Group (Team)**

Dr. Alketa Grepcka



Dr. Ervin Ramollari

